



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Gjuhë dhe
Letërsi Angleze”**

Kolegji Universitar “Bedër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Dr. Etleva Kondi

Prof. Asoc. Dr. Gentjana Taraj

Dhjetor/2024

Tabela Përmbledhëse për Programin e studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë " KU Bedër"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr.330, datë 07.08.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr.14, datë 28.02.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim Nr.36, datë 31.05.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët	-
15	Diplomë e dyfishtë	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2021-2022: 6 PAE/OPAK V.a 2022-2023: 8 PAE/OPAK V.a 2023-2024: 9 PAE/OPAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2021-2022 9 studentë V.a 2022-2023 8 studentë V.a 2023-2024 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit "Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze" është program i ciklit të dytë të studimeve, i cili ofrohet nga Kolegji Universitar "Bedër" (KU "Bedër"), i licensuar me vendim të Këshilit të Ministrave me VKM, Nr.286, datë 6.04.2011. KU "Bedër" është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jotitimprurëse. Në përbërje të këtij institucioni janë dy njësi kryesore:

- Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë
- Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit

KU "Bedër" ka kaluar tre akreditime institucionale: i pari akreditim është realizuar në vitin 2013 nga APAAL. Më pas institucioni është riakredituar nga Agjensia Britanike e Sigurimit të Cilësië dhe ASCAL, viti 2017 dhe riakreditimi i tretë është bërë gjatë vitit 2020-2021 ku me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.57, datë 16.12.2021, institucioni u akreditua deri në vitin 2026.

Programi Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze", i cili ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze u hap për herë të parë me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 330, datë 07.08.2012. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" ka një kurrikul me 120 kredite të shtrira në dy vite akademike, 4 semestra me nga 15 javë akademike. Struktura dhe organizimi i programit realizohet në përputhje të plotë me legjislacion në fuqi (ligji Nr.80/2015) dhe specifikat e përcaktuara në VKM Nr. 41/2018 "Për elementët e Programave të studimit të ofruara nga IAL". Plani mësimor i programit të studimit i ndan lëndët sipas kategorive A-E dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), ku lëndët bazë (A) zënë 10%, lëndët karakterizuese (B) 50%, lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 15%, lëndët plotësuese zënë 10% dhe detyrimet përbyllëse zënë 15%.

Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" për vitin akademik 2023-2024 është në total nëntë (9) personel efektiv me kohë të plotë (PAE) dhe 0 (zero) personel akademik me kontratë (PAK)

Programi i studimit synon formimin intelektual të studentëve dhe qasjen e tyre në një sërë karrierash profesionale. Qëllimi kryesor i programit është të përgatisë ekspertë me kualifikim profesional në shkenca humane, si: letërsi britanike dhe amerikane, linguistikë, përkthim, kulturë dhe traditë perëndimore si dhe njohuri të thelluara në fushat e ndërlidhura të studimit si: historia, sociologjia dhe politika, të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të reja të tregut dhe zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vend.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;


Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm, i ngritur në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe ASCAL, ka në përbërje të tij 2 (dy) profesorë: **Prof.Asoc.Dr. Etleva Kondi** dhe **Dr. Gentjana Taraj** dhe 1 (një) koordinator teknik të Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), **znj. Alma Arapi**. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është realizuar duke përcaktuar qartë mes anëtarëve përgjegjës dhe detyrat e gjithë secilit.

Procesi i Vlerësimit të Jashtëm të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” i ofruar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze në KU “Bedër” kaloi në disa etapa. Në fillim, grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) ju vu në dispozicion nga ASCAL dosja e plotë e vlerësimit së bashku me raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) si dhe gjithë dokumentacioni i përfshirë në të.

Informacioni i përmendur më sipër u vendos në dispozicion të GVJ-së 1 (një) muaj para vizitës në institucion, kohë e mjaftueshme për të lexuar, kuptuar dhe saktësuar informacionin e paraqitur në DVV si dhe evidencat për plotësimin e standardeve dhe kriterëve brenda fushave të RVB-së. Më pas, për të kuptuar me qartë, verifikuar dhe konkretizuar përfundimet e GVJ-së në lidhje me plotësimin e kriterëve nga programi i studimit, grupit ju dha mundësia e një vizite 2 (dy) ditore në institucion, e cila bazohej në një agjendë të përcaktuar qartë.

Vizita në KU “Bedër” u realizua gjatë periudhës 7-8 Mars 2024. Gjatë kësaj vizite GVJ-ja realizoi takime me dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Drejtësisë, përgjegjësen e Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, sekretarinë mësimore, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, NJSBC-në, zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe zyrën e Marrëdhënieve me Publikun. Në fund të vizitës GVJ vizitoi mjediset mësimore, laboratorët kompjuterikë, bibliotekën fizike etj.

Vizita në institucion dhe krahasimi i përfundimeve të dala gjatë vizitës me dokumentacionin e përfshirë në DVV, e ndihmuan GVJ-në të krijojë një ide më të qartë në lidhje me procedurat e organizimit dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e aktorëve të përfshirë në realizimin dhe menaxhimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze” i ofruar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze. Burimet njerëzore në dispozicion të programit sikurse dhe infrastruktura, e cila mbështet realizimin e programit të ciklit të dytë, përforcuan konstatimet dhe përfundimet e shprehura nga GVJ-ja në vazhdim, në formën e raportit të vlerësimit të jashtëm.



AKRONIME

DVV	Dosja e Vetvlerësimit
RVB	Raporti i Vlerësimit të brendshëm
GVB	Grupi i Vlerësimit të brendshëm
GVI	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
RVJ	Raporti i Vlerësimit të Jashtëm
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personel Akademik me Kohë të Plotë
PAK	Personel Akademik me Kontratë



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 36, datë 31. 05. 2019 janë:

- a. Institucioni, të rrisë përfshirjen e tij në projekte ndërkombëtare, si psh. Erasmus+, Horizon 2020 etj. duke i ardhur në ndihmë stafit akademik e studentëve të këtij programi studimi.
- b. Institucioni, të rrisë përfshirjen e stafit akademik e studentëve të këtij programi studimi në programe mobiliteti në universitete të ndryshme jashtë vendit, kryesisht në vende të Bashkimit European.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- a. Rekomandimi i parë, i cili kërkon përfshirjen e institucionit në projekte ndërkombëtare si psh. Erasmus+, Horizon 2020 etj., konsiderohet nga GVJ-ja i plotësuar. Për realizimin e këtij rekomandimi KU "Bedër", ka hartuar një Planveprim si pasojë e të cilit numri i marrëveshjeve ndërkombëtare në nivel institucional është rritur. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze që ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" ka fituar një projekt dhe ka qenë zbatues i dy të tjerëve. Megjithatë, më shumë duhet bërë në këtë drejtim.
- b. Përsa i takon rekomandimit të dytë të Bordit të Akreditimit në lidhje me përfshirjen më të madhe të stafit akademik dhe të studentëve të këtij programi studimi në programe mobiliteti në universitete të ndryshme jashtë vendit dhe kryesisht në BE, GVJ-ja e konsideron pjesërisht të plotësuar. Ndonëse ka një përfshirje të stafit akademik në programe e mobilitetit (3 staf akademik nga 9 PAE, në departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze) kanë qenë pjesëmarrës në këto programe, numri i studentëve të përfshirë në mobilitet është zero.

Kolegji Universitar “Bedër” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.11.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 101/ 18 Prot, datë 13.11.2024. Kolegji Universitar “Bedër” njofton në ASCAL më datë 21.11.2024, me anë të shkresës me Nr.296/2 Prot, datë 21.11.2024 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 296/2 Prot, Datë 21.11.2024

Pasi u njoh me komentet e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze pranë Kolegjit Universitar “Bedër” në lidhje me rekomandimet e dhëna në draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm mbi Programin Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sqaron si më poshtë vijon:

Komenti 1 (Standardi II.1, Kriteri 1)

Nga Tabelat bashkangjitur Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe Evidenca Shtesë nr.7 (Tabelat e Rishikuar, datë 21.03.2024), GVJ-ja konstatoi se ndarja e lëndëve në kategoritë përkatëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” nuk i përket nivelit (7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) për ciklin e dytë të studimeve, pasi është e ndarë në veprimtari formuese sipas nivelit 6 të KSHK-së që përkon me ciklin e parë të studimeve.

Në lidhje me këtë konstatim institucioni argumenton se ndarja e veprimtarive formuese në programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është në përputhje me VKM 41 dt.24.01.2018 duke paraqitur një evidencë të re (Evidenca nr. 1 datë 21.11.2024).

**GVJ-ja e merr në konsideratë këtë evidencë dhe e quan kriterin të plotësuar.
Sugjerimi hiqet dhe ndryshimi reflektohet në raport.**

Komenti 2 (Standardi I.3; IV.2 Kriteri 5)

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet në institucion, GVJ-ja konstatoi probleme në zhvillimin e praktikës profesionale për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në ‘Gjuhë dhe Letërsi Angleze’ duke dhënë sugjerimet e mëposhtme:

Së pari, të përcaktohen qartë numri i orëve pasive apo aktive që duhet të realizojë studenti në institucionin ku do të zhvillojë praktikën profesionale.

Së dyti, të saktësohet qartë lloji i aktiviteti që studenti pritët të realizojë në këto institucione për çdo ditë dhe orë që do kalojë aty si dhe instrumentet me të cilin do të realizohet vlerësimi i kompetencave që studenti fiton gjatë kësaj praktike.

Së treti, të përshtatet formulari i vlerësimit që institucioni pritës plotëson në varësi të aftësive profesionale që fiton studenti pranë tij dhe llojit të aktivitetit që realizon gjatë praktikës profesionale (psh., mësimdhënie ose përkthim).

Në lidhje me këto sugjerime, institucioni ka vënë në dispozicion disa evidenca (Evidenca mbështetëse nr. 2, 3, 4, 5, 6 datë 21.11.2024), të cilat nuk u japin përgjigje pikave të mësipërme. Për shembull, sikurse është përmendur edhe në draft-raport formulari i vlerësimit nuk reflekton vlerësimin e aftësive profesionale të studentit. Në tërësi ky formular vlerëson aftësinë e studentit për të punuar në grup dhe korrektësinë e studentit në respektimin e orarit dhe rregullave të institucionit ku realizohet praktika profesionale.

Për këtë arsye rekomandimet e GVJ-së në lidhje me praktikën profesionale nuk ndryshojnë. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

Komenti 3 (Standardi III.2, Kriteri 3)

Në lidhje me sillabuset e lëndëve, GVJ-ja sugjeroi që format e vlerësimit të dijeve në programet lëndore të jenë në përshtatje me rregulloren. Po kështu, GVJ-ja sugjeroi që krahas formave të vlerësimit të vazhdueshëm të përfshihej në sillabus dhe konvertimi i vlerësimit përfundimtar nga përqindje në gërmë sipas sistemit Amerikan dhe notë sipas sistemit Shqiptar të vlerësimit.

Institucioni argumenton se konvertimi i notës përfundimtare sipas sistemit Shqiptar të vlerësimit me notë gjendet te Guida e studentit dhe Rregullorja e Studimeve për Ciklin e Dytë.

GVJ-ja e merr në konsideratë argumentimin e institucionit në lidhje me mos përfshirjen e vlerësimit përfundimtar në sillabus.

Sugjerimi sugjerimi hiqet dhe ndryshimi reflektohet në raport.

Komenti 4 (Standardi III.5, Kriteri 3 dhe 4)

GVJ-ja bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion deri në datën 21.03.2024, ka rekomanduar përcaktimin e qartë të kriterëve mbi të cilat bëhet vlerësimi i temës së diplomës si dhe % për secilin kriter si psh., originaliteti i punimit, stili i shkrimit, metodologjia e përdorur, prezantimi etj. Për këtë arsye GVJ-ja, ka rekomanduar që kriteret e vlerësimit të tezës së diplomës nga komisioni të përcaktohen qartë dhe të bëhen pjesë e rregulloreve që prekin veprimtarinë e programit të studimit.

Me kënaqësi, GJVJ-ja konstaton se institucioni i ka pranuar këto sugjerime dhe ka reaguar pozitivisht duke realizuar plotësimin e tyre, e vërtetueshme kjo përmes evidencave shtesë të vëna në dispozicion të GJVJ-së në datë 21.11.2024 (Evidenca mbështetëse nr. 7, 8, 9, 10, 11). Rekomandimi hiqet dhe reflektohet në raport.

Komenti 5 (Standardi IV.1)

Bazuar në udhëzimin nr. 29 datë 10.09.2018 të MAS, GJVJ-ja konstatoi se për disa personel akademik me kohë të plotë ngarkesa mësimore vjetore përmbante në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale ose 3 lëndë vjetore. Për këtë arsye rekomandoi rishikimin e ngarkesës.

Institucioni e argumenton përcaktimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik me kohë të plotë në Kolegjin Universitar "Beder" të mbështetur në dispozitën e fundit të këtij udhëzimi, III. pika 5.

**GVJ-ja e merr në konsideratë këtë evidencë.
Sugjerimi hiqet dhe ndryshimi reflektohet në raport.**

Komenti 6 (Standardi VI.1; Standardi VI.3 Kriteri 4; Standardi VI.5 Kriteri 1)

Në lidhje me detyrimin e institucionit për të patur transparencë mbi veprimtarinë dhe funksionimin e tij jo vetëm ndaj stafit akademik, administrative dhe studentëve, por edhe palëve të treta dhe publikut, GJVJ-ja e sheh përdorimin e web-it të institucionit si një mjet efikas për realizimin e këtij detyrimi. Për këtë arsye, GJVJ-ja rekomandoi plotësimin e web-it zyrtar me të gjithë informacionin që reflekton kuadrin ligjor rregullator mbi të cilin ky institucion ushtron veprimtarinë e tij akademike bashkë me dokumenta të tjera të rëndësishme si Rregullorja Themelore dhe Statuti i Institucionit, Plani Strategjik, Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, Vendimet e Rektorit, Vendimet e Senatit etj. Po kështu të jetë e dukshme për publikun mënyra sesi realizohet vlerësimi i brendshëm i cilësisë, raportet e vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, raportet e përvitshme vjetore, etj. Këto informacione dhe të tjera duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit nga kushdo që është i interesuar.

Me kënaqësi GJVJ-ja konstaton se institucioni e ka marrë për bazë këtë rekomandim të GJVJ-së (link-et e cituara në Komentet e Institucionit mbi draft-raportin e vlerësimit të jashtëm, datë 21.11.2024) dhe sikurse pranohet nga vetë institucioni puna për ngarkimin e dokumentacionit po vazhdon.

GVJ-ja është e mendimit që ky rekomandim të mbetet i vlefshëm deri në përfundimin e plotë të këtij procesi.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e referuar në Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm të Masterit të Shkencave në ‘Gjuhë dhe Letërsi Angleze’, konstatohet se Kolegji Universitar (KU) “Bedër” është licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 286 datë 6.04.2011 (Evidenca nr. 11 –Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për licensimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe ka kaluar me sukses tre akreditimi institucionale (2013; 2017; 2021) Evidenca nr. 40 –Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2013; Evidenca nr. 41 –Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2017; Evidenca nr. 42 –Vendimi i Akreditimit Institucional, viti 2021; Në përbërje të tij janë dy fakultet (Evidenca nr. 7 –Organograma e Kolegjit Universitar “Beder”): ◆ Fakulteti i Teknologjisë dhe Bisnesit dhe ◆ Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, i cili ofron dhe Programin Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, i hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 330 datë 07.08.2012 (Evidenca nr. 15 –Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”). Nga dokumentacioni i referuar këtij kriteri në Raportin e Brendshëm të Vlerësimit (DVV), (Evidenca nr.2 – Statuti i Kolegjit Universitar “Beder”; Evidencë nr.9- Plani Strategjik Institucional 2018-2023; Evidenca nr.10-Plani Strategjik 2024-2028), GVJ-ja konstaton se KU “Bedër”, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, të

	parashikuara në Statutin dhe në planin e tij strategjik.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në evidencat e cituara në këtë kriter GVJ-ja konstaton se kriteri plotësohet plotësisht. Programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” i ofruar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze është në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit dhe fushën e veprimtarisë së tij. Në Rregulloren e Departamentit shprehet qartë misioni i këtij departamenti për të ofruar programe bashkëkohore studimi, të cilat synojnë të formojnë përkthyes/redaktues në media, komunikues ndërkulturore, akademikë, mediatorë në institucione publike dhe private etj. (Evidenca nr.3 – Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Beder”, Neni 52; Evidenca-7-Organograma e Kolegjit Universitar “Beder”; Evidenca nr.8–Organograma e Fakulteteve të Kolegjit Universitar “Beder”; Evidenca-9-Plani Strategjik Institucional 2018-2023; Evidenca-10-Plani Strategjik Institucional 2024-2028; Evidenca nr.6 -Rregullorja mbi Organizimin Administrativ; Evidenca nr.13 -Rregullorja e Bordit të Administrimit; Evidenca nr.12 -Rregullorja mbi Organizimin Akademik)
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	Programi i Studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr. 330, datë 07.08.2012 (Evidenca nr. 15 –Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të referuar në këtë kriter GVJ-ja konstaton se programi është hartuar dhe ofrohet në zbatim të drejtimeve prioritare akademike të Kolegjit Universitar “Beder”, i cili synon ofrimin e programeve cilësore të studimit në disiplina të ndryshme për të ndihmuar studentët e diplomuar të përshtaten me kërkesat e tregut të punës. Programi është në përputhje me objektivat dhe vizionin e Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze të Huaja si dhe në përputhje dhe në zbatim të Statutit dhe Rregullores së KU “Beder”, të cilat kanë përcaktuar qartë fushat dhe drejtimit akademike të institucionit. (Evidenca nr.3 – Rregullore Themelore e Kolegjit Universitar “Beder”) dhe Evidenca nr.10- Plani Strategjik Institucional 2024-2028).
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet	GVJ-ja konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, pranë KU




në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	“Bedër”, ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit. Plani strategjik i këtij institucioni për harkun kohor 2018-2023 dhe 2024-2028, ka për qëllim të sigurojë një arsim cilësor, i cili reflektohet dhe në misionin e programit (Evidencë nr.5-Rregullorja e programit të studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”). Ky program studimi synon përgatitjen e studentëve në shkencat humane duke i pajisur me njohuri të thelluara në fusha si historia, politika dhe sociologjia.			
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se KU “Bedër”, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, të parashikuara në Statutin e Kolegjit. Gjithashtu, GVJ-ja konstaton se hartimi dhe ofrimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” bëhet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit të shprehura qartë në Statutin dhe Rregulloren e tij si dhe në strategjitë e zhvillimit institucional, e cila është konform strategjisë kombëtare dhe prirjeve globale të zhvillimit. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, programi synon përgatitjen e profesionistëve në shkencat humane si letërsi britanike dhe amerikane, gjuhësi, kulturë dhe traditë perëndimore, në përputhje me fushën akademike e kërkimore të KU “Bedër”, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, dhe të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, i cili ofron këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike	GVJ-ja konstaton se në përbërje të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” për vitin akademik 2023-2024 ka në

specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	total nëntë (9) personel akademik, nga të cilët, të gjithë janë (9) personel akademik efektiv (PAE), dhe asnjë (0) personel akademik me kontratë (PAK). Prosoneli akademik efektiv (PAE) i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze për vitin akademik 2023-2024, në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” ka kualifikimet e mëposhtme: dy (1) Profesorë të Asociuar; pesë (4) Doktorë të Shkencave; dy (4) MSc. Përsa i përket kualifikimeve të personelit akademik me kontratë, GVJ-ja konstaton se që nga viti akademik 2021-2022 numri i tyre është reduktuar në zero (0, PAK). (Tabela nr.2, Shtojca 1).
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion në DVV-në e programit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, rezulton se fusha e përgjithshme e programit shtrihet në lëmin e gjuhësisë së aplikuar dhe studimeve kulturore dhe letrare, ndërsa ajo më specifike në përgatitjen e specialistëve në fushën e letërsisë britanike dhe amerikane, gjuhësi, kulturë dhe traditë perëndimore. GVJ-ja konstaton se veprimtaria e departamentit dhe programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Rregullorja e programit të studimit e bazuar në Rregulloren e Fakultetit dhe Kolegjit Universitar “Bedër” siguron ofrimin e programit të studimit në përshtatje të vizionit të saj me fokus përgatitjen e ekspertëve në fushën e gjuhës dhe letërsisë Amgleze. (Evidenca-4-Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca-5-Rregullorja e programit të studimit "Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze"). Nga dokumentacioni i përfshirë në DVV, rezulton se programi i studimit ofrohet me 120 kredite, sipas sistemit (ECTS), dhe realizohet me kohë të plotë në dy (2) vite akademike.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë	Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, tregon se programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” përputhet me fushën akademike dhe studimore të njësisë bazë, e cila e ofron këtë program. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ofron ndër të tjera ekspertizë në fushën e gjuhës dhe letërsisë angleze, objektivi i të cilit është rritja e cilësisë në mësimdhënie dhe përgatitjen e studentëve të diplomuar sipas nevojave të tregut të punës brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të Statutit dhe

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Rregullores së KU “Bedër”, Rregulloren e njësisë kryesore dhe njësisë bazë.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	NA			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga dokumentacioni i paraqitur në këtë kriter rezulton se KU “Bedër” dhe Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ofrojnë trajnime të vazhdueshme për studentët, stafin dhe studentët e diplomuar. Nga dokumentacioni i përfshirë në DVV, rezulton se KU “Bedër” ka nënshkruar në nivel institucioni 68 marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit nga të cilat tetë (8) janë marrëveshje mobiliteti në kuadër të programit Erasmus +. Vlen të përmenden trajnimet në bashkëpunim me ‘Educators without Borders’, ku pjesëmarrës janë dhe studentët e diplomuar. (Evidenca nr.33- Webinare nga “Educators without Borders”; Evidenca nr.79-Marrëveshje bashkëpunimit me Universitetin e North Dakota; Evidenca nr. 80-Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof.Dr. Woei Hung, Mobiliteti me Institucionet Homologe),			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.</i> <i>Po ashtu, GVJ konstaton se kapacitetet njerëzore të njësisë bazë për të ofruar programet e ciklit të parë dhe të dytë janë të mjaftueshme për të menaxhuar programet e studimit. Nga CV-të e personelit rezulton se në përgjithësi formimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e programit të studimit.</i> <i>Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Për këtë arsye, GVJ-ja e konsideron këtë standard të përmbushur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ-ja konstaton se bazuar në kuadrin rregullator të brendshëm, njësia bazë ndjek një praktikë të vazhdueshme bashkëpunimi me njësitë e tjera akademike dhe administrative brenda institucionit për të siguruar mbarëvajtjen e punëve në menaxhimin dhe zbatimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”. Në fillim të çdo viti, njësia bazë përcakton koordinаторët e programeve, këshilltarët akademik për çdo grup studentësh, përfaqësuesit e tyre në zyrën e Këshillimit dhe Karrierës si dhe në zyrat e tjera. Analiza e vazhdueshme e punës së tyre, reflektohet në Raportin vjetor të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, për programin e studimit dhe për veprimtarinë mësimore–shkencore. (Evidenca nr.12-Rregullore e Organizimit Akademik; Evidenca nr.38-Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Koordinatorëve të Programit; Evidenca nr.36-Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë; Evidenca nr.37-Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përfatimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e tjera.) (Evidenca-35- Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2022-2023)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Nga dokumentacioni i cituar në RVB për këtë kriter, rezulton se KU “Bedër” ka nënshkruar në nivel institucioni 68 marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit nga të cilat tetë (8) janë marrëveshje mobiliteti në kuadër të programit Erasmus + (Evidenca nr.44- Marrëveshje bashkëpunimi (aktive) dhe Mobiliteti me Institucionet Homologe, brenda dhe/ose jashtë vendit). Nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ-ja pas vizitës në institucion (Evidencë Shtesë nr.6 Mobilitetet për stafin.pdf ngarkuar në sistemin e ASCAL në datën 21.03.2024), rezulton se në nivel departamenti nga viti 2019 e në vazhdim janë realizuar nga stafi akademik 5 (pesë) mobilitete përkatësisht 1 (një) në vitin 2019,

	2022 dhe 3 (tre) në vitin 2023 (në total 3 staf akademik), por nuk ka asnjë mobilitet ku janë të përfshirë studentët. GVJ-ja rekomandon domosdoshmërinë e shtimit të numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet e ndryshme në BE dhe më gjerë si dhe një përfshirje më të plotë të stafit akademik dhe studentëve në programet e mobilitetit.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i prezantuar në DVV, GVJ-ja konstaton se në nivel institucioni, KU "Bedër" ka nënshkruar 32 marrëveshje partneriteti dhe 68 marrëveshje bashkëpunimi dhe mobiliteti me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Në nivel departamenti, janë nënshkruar pesë (5) marrëveshje me institucione dhe organizata bashkëpunuese për realizimin e praktikës profesionale, ku studentët e programit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" mund të realizojnë praktikën profesionale (Tabela 5, shtojca 1). Megjithatë, bazuar në dokumentacionin e përfshirë në DVV dhe pas takimit me përgjegjësin e njësisë bazë dhe stafin akademik, GVJ-ja konstaton se studentët e programit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze", e realizojnë praktikën profesionale kryesisht pranë KU "Bedër" si asistentë profesorë për nivelin e parë të studimeve BSc në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" dhe jo pranë institucioneve me të cilat institucioni ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e praktikave profesionale. Në një rast të vetëm, të referuar në Evidenca Shtesë nr.1 Raste Praktike Profesionale MSc ELL kur kjo praktikë është zhvilluar pranë kompanisë "Connection Project", e cila nuk gjendet në Tabelën nr.5 të RVB-së, edhe pas kërkesës së GVJ-së nuk u paraqit asnjë marrëveshje bashkëpunimi midis KU "Bedër" dhe kompanisë "Connection Project" për zhvillimin e praktikës profesionale. (Evidenca nr.77- Lista e Institucioneve me të cilat ka Marrëveshje bashkëpunimi dhe Evidenca nr.44- Marrëveshje bashkëpunimi (aktive) dhe Mobiliteti me Institucionet Homologe, brenda ose jashtë Vëndit).
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga	Referuar informacionit në Raportin Vjetor të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, për vitin akademik 2022-2023, GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, harton raporte analitike vjetore për të evidentuar përfitimin nga zbatimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të programit të

marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, Master Profesional në “Mësuesi: Gjuhë Angleze” dhe Formim i Vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike. <i>GVJ-ja konstaton se në raportin vjetor të departamentit për vitin 2022-2023, analizohet vetëm realizimi i praktikës profesionale nga studentët e programit Master Profesional në Mësuesi, e cila është realizuar në 4 DRAP kryesore në zona rurale dhe urbane, por nuk ka asnjë informacion mbi praktikën profesionale të programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” çka e bën të paqartë përfitimin që kanë studentët e këtij programi nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet pritëse.</i> (Evidenca nr. 35 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, viti akademik 2022-2023).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU “Bedër” ka krijuar një sistem funksional për të arritur një mirëorganizm dhe koordinim të zyrave dhe njësive në përbërje të tij. Përveç kësaj, institucioni punon sitematikisht për realizimin e objektivave të procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit. Ndërsa numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucional është i konsiderueshme,</i> <i>GVJ konstaton se numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mobiliteti si për stafin akademik ashtu dhe për studentët e departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze është i vogël dhe rekomandon që të punohet më tepër në këtë drejtim.</i> <i>Po kështu, GVJ-ja rekomandon rishikimin e marrëveshjeve, ku studentët e programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” mund të kryejnë praktikat profesionale. Rritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar ndihmon në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve, si dhe zhvillimin e praktikave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
-----------------------	-----	------------	------------	------------

së standardeve të fushës	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ-ja konstaton se programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, i cili ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, me, Udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”; VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe me Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (Evidenca nr.45 – Për Organizimin e Praogrameve në Institucionet e Arsimit të Lartë”). Programi i studimit është është i organizuar në dy vite akademike, secili katër semestra me 30 kredite, i ndarë në lëndë dhe module sipas kategorive A-E. <i>GVJ-ja konstaton, se ndonëse kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” përmban veprimtaritë formuese të kategorive (A-E) sipas VKM 41, 2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të”, me lëndë, të cilat janë të kodifikuara dhe përmbajnë kreditet respektive të tyre, ndarja e lëndëve në kategoritë përkatëse nuk i përket nivelit (7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) për ciklin e dytë të studimeve, por është e ndarë në vdeprimtari formuese sipas nivelit 6 të KSHK-së që përkon me ciklin e parë të studimeve.</i> <i>Gjithashtu, GVJ-ja konstaton se pavarësisht se emërtimi i programit është “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, raporti midis lëndëve gjuhësore dhe letrare nuk është i balancuar. Kurrikula e programit përmban vetëm 2 lëndë që i përkasin gjuhësisë së aplikuar dhe pjesa tjetër janë të lidhura me fushën e letërsisë. Ndaj rekomandojmë ose rregullimin e këtij raporti ose ndryshimin</i>

	<i>e emërtimit të programit.</i> <i>Kjo do të saktësonte dhe hapësirat e punësimit për studentët e këtij programi në mënyrë që kompetencat e fituara gjatë programit të studimit të jenë të përshtatshme për sektorët e punësimit që synon ky program. Më konkretisht, plani mësimor i programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” ofron vetëm një lëndë përkthimi, gjë që nuk e bën këtë program të përshtatshëm në diplomimin e përkthyesave. Ky program nuk u ofron studentëve kompetencat e nevojshme për të punuar si përkthyes.</i> (Evidencë Shtesë nr.7 Tabelat e Rishikuar).
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” (Evidenca nr.5) konstatojmë se programi i studimit synon formimin teorik dhe praktik të specialistëve në fushën e filologjisë dhe gjuhësisë. Në përfundimin me sukses të programit, studentët e diplomuar kanë mundësi të punojnë si në sektorin privat ashtu dhe atë publik në çdo drejtim që ka lidhje me letërsinë, kulturën, gjuhën siç janë për shembull, redaktimi, komunikim ndërkulturor, mësimdhënia në arsimin e lartë si dhe fusha studimore e kërkimore. Programi synon nxitjen e të menduarit kritik dhe aftësimin e kërkimit shkencor të studentit.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” ka të përcaktuar në ngarkesën e tij dhe praktikën profesionale me 12 kredite. Sipas planit mësimor, kjo praktikë zhvillohet nga studentët në semestrin e katërt. <i>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet në institucion mbetet e paqartë për GVJ-në mënyra se si realizohet Praktika Profesionale nga studentët e këtij programi.</i> <i>GVJ-ja konstaton se mënyra sesi planifikohet dhe zhvillohet praktika profesionale në këtë program nuk është e parashikuar as</i>

	<i>në një rregullore të veçantë dhe as në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë.</i> <i>Së pari, GVJ-ja rekomandon të saktësohen orët që studentët kalojnë në institucionet, ku zhvillojnë praktikën.</i> <i>Së dyti, të qartësohet aktiviteti i tyre në këto institucione si dhe mënyra e vlerësimit të kompetencave që studenti fiton gjatë kësaj praktike.</i> <i>Së treti, formulari i vlerësimit që institucioni pritës plotëson nuk mund të jetë i njëjtë si në rastin e mësimdhënies ashtu dhe të përkthimit duke qenë se aftësitë që studenti pritës fitojë nuk janë të njëjta.</i> <i>GVJ-ja rekomandon, saktësimin në planin mësimor të orëve të praktikës aktive që studenti duhet të realizojë pavarësisht institucionit ku vendos ta kryejë praktikën. Hartimi i formularëve të detajuar (sipas specifikave të kompetencave që studenti synon të fitojë), ku për çdo orë praktike studenti përshkruan aktivitetin që ka realizuar. Kjo mbështetet nga formulari i vlerësimit të institucionit pritës, i cili mbështet realizimin e të gjitha orëve nga ana e studentit dhe nënshkruhet nga eksperti i fushës përkatëse, i cili bën dhe vlerësimin.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm	NA

psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga dokumentacioni i përfshirë në DVV, GVJ-ja konstaton se programi i studimit Materi i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është i organizuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MAS dhe vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Në Rregulloren e programit të studimit gjenden të përcaktuara forma e organizimit të studimeve, objektivat formuese dhe profesionale, plani mësimor, kreditet sipas sistemit ECTS, kreditet dhe detyrimet penguese, forma e vlerësimit, frekuentimi. Transferimi i studimeve, shkrimi dhe vlerësimi i tezës janë të përcaktuara në këtë rregullore.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ-ja konstaton se referuar RVB-së (Evidenca nr. 95-Shembuj kurrikule të programeve Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në rajon) si dhe informacioneve shtesë të marra gjatë vizitës në institucion me drejtuesit e njësive kryesore dhe njësive bazë, përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është i ngjashëm me programe të tjera studimi master shkencor, të ofruara në të njëjtën fushë studimi.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, programi i studimit ka ndjekur procedurën e nevojshme dhe ka marrë kodin e tij përkatës në përputhje me fushën e studimit dhe klasifikimeve të përcaktuara nga MAS. Kodi i programit të studimit është 72 MS 0232 A . GVJ-ja konstatoi se jo vetëm programi, por edhe lëndët e programit kanë marrë kodin e tyre, të reflektuar në planin mësimor si dhe sillabuset e lëndëve. Konstatimi vjen nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë	NA




institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi i studimit Mater i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë. Ky program synon formimin praktik dhe teorik të ekspertëve në drejtimin filologji dhe letërsi ku pas diplomimit studentët mund të punësohen në sektorin privat dhe publik që lidhet me kulturën, letërsinë, redaktimin gjuhësor, përkthimin, komunikimin ndërkulturor dhe mësimdhënien në arsimin e lartë. Nga dokumentacioni në përbërje të DDV rezulton që përmbajtja e programit të studimit është e ngjashme me programe të tjera studimi master që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, brenda dhe jashtë vendit.</i> <i>Po kështu, GVJ-ja rekomandon qartësimin e mënyrës se si zhvillohet praktika profesionale në rregullore, duke filluar nga orët që studenti duhet të kalojë pranë institucionit pritës, te aktivitetet që duhet të realizojë aty e deri te formularët e vlerësimit, të cilët duhen plotësuar nga eksperti përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Në përbërje të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë janë katër departamente (Evidenca nr.8 – Organograma e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë): ◆ Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze; ◆ Departamenti i Drejtësisë; ◆ Departamenti i Shkencave të Komunikimit; ◆ Departamenti i Shkencave Islame. GVJ konstaton se programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Shkencave Humane dhe Drejtësisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze si njësi bazë. Të

dyja këto njësi përmbushin të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me organizimin, strukturën akademike, stafin akademik, vlerësimin dhe akreditimin.

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë për vitin-akademik 2023-2024 ka në strukturën e tij këto të dhëna

Personeli i angazhuar në FSHHD	2023-2024	
	PAE	PAK
Prof Dr	1	1
Prof.Assoc	4	2
Dr/Doc	12	6
Msc	21	12
Në total	38	21

Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ka në përbërje të tij për tri vite akademike 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024:

Personeli i angazhuar në DEGJA	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.Assoc	-	-	-	1	1	1
Dr/Doc	4	1	4	-	4	-
Msc	4	1	4	1	4	-
Në total	8	2	8	2	9	1

Evidenca nr.39 –Vendim për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm GVB.)

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e

Bazuar në vizitën dhe takimet e realizuara në institucion si dhe në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur në DVV, konstatohet nga ana e GVJ-së se programi i studimit ka të parashikuar në kurrikulën dhe planin e tij mësimor, praktikën profesionale.

përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë parashikon në nenin 11 të saj se ndjekja e ecures së praktikës dhe dokumentacioni përkatës realizohet nga koordinatori i departamentit për programet e ciklit të dytë. (Evidenca nr. 14 – Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze me vendim departamenti zgjedh një nga anëtarët e stafit akademik në funksionin e koordinatorit të programit (Evidenca nr. 38: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit. Bazuar në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit si dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale dhe detyrimeve të tjera në përputhje me objektivat e programit. (Evidenca nr.14- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve te Ciklit të Dytë.)			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si dhe Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën akademike, strukturën administrative, vlerësimin dhe akreditimin. Rregullorja Themelore e KU “Bedër”, ka të përcaktuar në Kreun 13 të saj realizimin e praktikave profesionale. Zhvillimi dhe ecuria e praktikave sikurse dhe realizimi në tërësi i programi të studimit realizohet nga koordinatori i programit, i cili është anëtar i departamentit dhe zgjidhet prej këshillit të njësive bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse	GVJ-ja konstaton se Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si njësi kryesore së bashku me Departamentin e Edukimit dhe

për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Gjuhës Angleze si njësi bazë, nga e cila ofrohet programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” disponojnë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Rregulloret e Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit janë hartuar bazuar në Statutin dhe Rregulloren Themelore të KU “Bedër” dhe përmbajnë të gjithë elementët dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me ofrimin dhe organizimin e programit të studimit, objektivat formuese si dhe karakteristikat e programit të studimit. (Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 4: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”)
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në Tabelën nr.10 të RVB, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit përmban emërtimin e lëndëve që zhvillohen në çdo vit akademik (dy vite akademike) dhe secilin semestër (4 semestra), numrin e krediteve (120 ECTS), orët mësimore të ndara në javë, orë të studimit në auditor dhe të studimit individual, si edhe totalin e orëve mësimore dhe studimit individual, ku studenti realizon jo më pak se 1500 të tilla. <i>GVJ-ja rekomandon që në planin mësimor të programit të rishikohet dhe saktësohet raporti i orëve që studentët kalojnë në auditor dhe atyre që zhvillohen në institucionet, ku ata kryejnë praktikën profesionale qoftë ky dhe KU “Bedër”. Në planin mësimor të programit janë parashikuar 4 orë provim për lëndën praktikë profesionale, gjë që e bën të paqartë mënyrën e vlerësimit të studentit në këtë lëndë dhe arsyet e realizimit të praktikës në institucionet pritëse dhe rolin e formularit të vlerësimit, që studenti merr nga këto institucione.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe	GVJ-ja konstaton se në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e studimeve dhe provime të ciklit të dytë si dhe në rregulloren e transferimit të studimeve gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, siç janë kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve.

ekuivalentimit të studimeve.	(Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë; Evidenca nr. 28: Rregullorja e Transferimit të Studimeve)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga Tabela nr.14 në shtojcën 1 të RVB-së, GVJ-ja konstaton se programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për programet lëndore të secilës lëndë. Syllabuset për secilën lëndë janë hartuar sipas formatit të përcaktuar dhe miratuar nga MAS. Në përbërje të tyre gjenden të gjithë komponentët e nevojshëm si emërtimi i lëndës, kodi i lëndës, tipologjia, ngarkesa javore e ndarë në leksione/seminare, numri i krediteve, përshkrimi dhe objektivat e lëndës, konceptet themelore, temat dhe kalendarin javor, literature e detyrueshme dhe e rekomanduar dhe format e kontrollit të dijeve. (Evidenca nr.17: Syllabus-et e Lëndëve të Programit)
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, GVJ konstaton se programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” i ofruar për herë të parë në vitin akademik 2012-2013 nuk ka kaluar asnjë proces riorganizimi për gati 12 vite. Gjithsesi, nga diskutimet me përgjegjësin e njësisë bazë, GVJ konstaton se programi i studimit është vazhdimisht objekt përmirësimi dhe përditësimi. Në fillim të çdo viti akademik, departamenti diskuton në mbledhjet e tij përditësimin e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar për çdo lëndë. (Evidenca nr. 15: Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”),(Evidenca nr.17: Syllabus-et e Lëndëve të Programit)
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Rregullorja e Fakultetit, Departamentit dhe programit të studimit përmbajnë gjithë informacionin e nevojshëm mbi ofrimin dhe realizimin e programit të studimit, si objektivat formuese, karakteristikat e programit, kriteret e pranimit të studentëve, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, mundësitë e punësimit etj. Plani mësimor i programit të studimit përmban informacionet për çdo lëndë, përfshi titullin e lëndës, kreditet, orët e studimit individual dhe në auditor, orët e lëndës për çdo javë, semestri dhe viti akademik kur zhvillohet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar si dhe format e vlerësimit.</i>

	GVJ-ja rekomandon rishikimin e planit mësimor për lëndën Praktikë me qëllim saktësimin e orëve që studenti kalon në terren.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ-ja konstaton se veprimtaritë mësimore, ngarkesa mësimore teorike dhe praktikat brenda dhe jashtë kurrikulare kanë një shpërndarje të balancuar çka çon në aftësimin praktik dhe teorik të studentëve me njohuri, dije, aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për të vazhduar studime të mëtejshme në nivel doktorature, por edhe për një punësim në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Evidenca nr. 95: Shembuj Kurrikule të programeve “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze” në Rajon; Evidenca nr.17: Syllabus-et e Lëndëve të Programit; Tabela nr.14).
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënësve dhe kërkimit shkencor.	Nga dokumentacioni në RVB (Tabela nr. 10, shtojca nr.1), GVJ-ja konstaton se planin mësimor i programit shtrihet në 4 semestra me nga 30 kredite, pra kemi një shpërndarje të barabartë të krediteve në vite e semestra, në orë mësimore në auditor dhe orë studimi individual, për studim, detyra, projekte, përgatitje për provime, përgatitjen e tezës apo veprimtari të tjera si intership-et pranë shkollave publike dhe jo publike, praktika etj. <i>Gjithsesi, GVJ konstaton se komponentët mësimorë të mësimdhënies në auditor që janë leksionet dhe seminarët, të cilët nxisin aftësimin teorik dhe praktik të studentëve në përdorimin e gjuhës së huaj dhe specifikat e fushave të përfshira në programin e studimit nuk kanë një ndarje të qartë. Ndërsa në Shtojcën nr.1 Tabela 13 theksohet se në total në program zhvillohen 896 orë leksione dhe seminare, në sillabuset e lëndëve ky raport humbet duke qenë se numri i seminareve prezantohet 0.</i> <i>Nga biseda me stafin akademik, GVJ-së ju konfirmua se është në</i>

	<i>dorën e pedagogut të lëndës nëse në një javë do zhvillojë leksione apo seminare, por askush nuk dinte të thoshte se si përcaktohet raporti leksion/seminar për çdo javë përgjatë semestrit.</i> <i>GVJ-ja rekomandon përcaktimin e qartë në planin mësimor dhe programin lëndor të raportit leksion-seminar për çdo lëndë dhe kohën e realizimit të tyre për të shmangur konfuzionin e lektorit, por edhe të studentit.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Bazuar në dokumentacionin e përfshirë në DVV dhe në konstatimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se struktura e programit është organizuar në përputhje me profilin e programit duke synuar formimin e specialistëve në dy fusha kryesore: filologji dhe gjuhësi. Gjithashtu, struktura e programit, lëndët dhe raporti teori–praktikë janë orientuar nga programe të ngjashme ndërkombëtare, gjë që mundëson përfshirjen e studentëve në programet e mobilitet studentor.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Referuar Tabelës nr.14, GVJ konstaton, se plani mësimor i këtij programi studimi pasqyron qartë ndarjen sipas veprimtarive formuese edhe raportin midis formimit teorik dhe atij praktik, gjë që mundëson realizimin e objektivave dhe krijon mundësinë e rritjes së numrit të studentëve që përfshihen në programe mobiliteti apo që dëshirojnë të transferojnë studimet brenda dhe jashtë vendit në programe të ngjashme studimi.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pas bisedave me përgjegjësin e njësisë kryesore dhe stafin akademik të angazhuar në program, GVJ-ja konstaton se programi lëndor i përmirësuar dorëzohet pranë koordinаторit të departamentit dhe ngarkohet në sistemin informatik <i>Bedër Information System (BIS)</i>. Ndonëse departamenti organizon në mënyrë të vazhdueshme workshop-e për përditësimin e syllabuseve, ku marrin pjesë anëtarë të departamentit. <i>GVJ-ja konstaton se pavarësisht përpjekjes për përditësim dhe përmirësim të programeve lëndore në shumicën e programeve lëndore, literatura e sygjëruar nga pedagogu mund të konsiderohet</i>

	<i>e vjetëruar, çka pengon dhënien e njohurive dhe kompetencave, sipas kërkesave të zhvillimeve bashkëkohore të tregut të punës.</i> <i>GVJ-ja rekomandon rifreskimin e literaturës së detyruar dhe të rekomanduar dhe zëvendësimin e saj me literaturë të viteve të fundit.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Rregullorja e programit specifikon se ky program synon të përfshijë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së studimit dhe synon t'i pajisë studentët me një sfond teorik për t'u bërë ekspertë në filologji dhe linguistikë. Nga plani mësimor i programit, GVJ-ja konstaton se përmbajtja e programit të studimit synon përfitim të dijeve specifike në fushën e filologjisë dhe gjuhësisë. Lëndët e ofruara nga programi i studimit lidhen me fushat e nevojshme për tu mundësuar studentëve punësimin apo vijimin e karrierës së tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh private apo publike, që kanë marrëdhënie me gjuhën dhe letërsinë angleze duke përfshirë redaktimin, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	GVJ-ja konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në dosjen e vetvlerësimit se përmbajtja e programit të studimit u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë. <i>Përsa i takon punësimin të tyre, GVJ-ja evidenton se Evidenca nr. 23- Studim Tregu i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze është realizuar para 5 viteve dhe fokusohet kryesisht në mësimdhënien e gjuhës Angleze si gjuhë e dytë nëpër shkollat e ciklit parashkollor, çka favorizon më tepër studentët që kanë zgjedhur masterin profesional dhe jo masterin shkencor. Duke qenë se tregu i punës ndryshon me ritme të shpejta, GVJ-ja rekomandon realizimin e studimeve periodike mbi tregun e punës sidomos të sektorëve, ku mendohet të punësohen studentët e këtij programi.</i> (Evidenca nr. 23: Studim Tregu i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze).
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" përcakton qartë mënyrën e organizimit, strukturën dhe përmbajtjen e programit duke bërë të mundur marrjen e njohurive të qëndrueshme dhe thellimin e tyre. Gjithashtu, ngjashmëria e planit të programit me programe të tjera të të njëjtit lloj dhe rregullorja e transferimit të studimeve u krijojnë studentëve mundësinë për të vijuar studime të mëtejshme si brenda dhe jashtë vendit, transferimin e studimeve si dhe mobilitete</i>

	<i>në universitete me të cilat KU "Bedër" ka marrëveshje partneriteti.</i> <i>Për të realizuar këto objektiva si dhe për t'iu përshatatur më së miri kërkesave të tregut për punësim në fushat që aftëson programi, GVJ-ja rekomandon realizimin periodik të analizës së tregut të punës në sektorët, ku studentët e këtij programi mund të punojnë.</i> <i>GVJ-ja rekomandon saktësimin në planin mësimor dhe programin lëndor të raportit leksion-seminar për çdo lëndë.</i> <i>GVJ-ja rekomandon përditësimin e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar me literaturë të viteve të fundit, për tju përgjigjur më mirë zhvillimeve të fundit në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në RVB thuhet se Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë hartojnë politika zhvillimore në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojave të tregut të punës. Si evidencë për këtë i referohen raportit të detajuar të studimit të tregut të punës para hapjes së programit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze". <i>GVJ-ja konstaton se ky raport mungon në DVV.</i> Studimi i Tregut për vitin 2018, i paraqitur si evidencë, merret kryesisht me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri për mësues të gjuhës angleze në arsimin parauniversitar, por jo me mundësitë e punësimit të studentëve në drejtime specifike të synuara nga programi si psh., përkthyes apo redaktorë (Evidenca nr. 23: Studim Tregu i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze). <i>GVJ-ja konstaton se numri i vogël i studentëve, të cilët kryejnë</i>

	<i>praktikën pranë institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese me KU "Bedër" është shumë i vogël, gjë që nuk favorizon mundësinë e shkëmbimit të mendimeve dhe marrjen parasysh të propozimeve të të gjitha palëve të përfshira në funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe arritjes së objektivave të tij.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ-ja konstaton se KU "Bedër" përdor forma të ndryshme të nxitjes dhe përfshirjes së studentëve për të rritur cilësinë e programit të studimit. Nga diskutimi me studentët, GVJ-ja konstatoi se një nga format e përfshirjes së studentëve në diskutime mbi cilësinë dhe përmirësimin e programit të studimit është pjesëmarrja e tyre në mbledhjet e departamentit. Aty studentët japin mendimet e tyre mbi programin dhe lëndët, të cilat pastaj reflektohen në ndryshimet e programit nëse gjykohet se janë në funksion të përmirësimit të tij. Studentët theksuan se problemet apo mangësitë që ata kanë vënë në dukje janë minimizuar dhe kanë gjetur zgjidhje. Përveç kësaj, në shërbim të përmirësimit të programit, institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, sugjerimet e të cilëve merren përmes anketës për vlerësimin e programit (Evidenca nr. 102: Anketë Vlerësimi e të Diplomuarve për Programin e Studimit)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Nga dokumentacioni në DVV, plani strategjik i KU "Bedër", takimit me stafin akademik, drejtuesit e njesisë kryesore dhe njesisë bazë, GVJ-ja konstaton se institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe publike dhe private, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj në bashkëpunim me të cilët ka organizuar dhe zhvilluar trajnime të ndryshme për stafin dhe studentët, konferenca, projekte dhe bashkëpunime me synim përmirësimin e programit të studimit. Sipas RVB një praktikë e konsoliduar për rritjen e cilësisë së programit është përditësimi i sillabuseve.
Konkluzione	<i>Plani strategjik i KU "Bedër" synon rritjen e cilësisë në mësimdhënie, gjë që kërkon një angazhim të vazhdueshëm dhe përfshirjen e të gjithë strukturave brenda institucionit për të arritur përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet kërkimore-shkencore, publike e private përmes</i>

	<i>marrëveshjeve me institucione partnere. Ruajtja e vazhdueshme e kontaktit me studentët e diplomuar dhe anketimi i tyre në lidhje me cilësinë e programit, i shërben qëllimit të përmirësimit të tij. Po kështu përfshirja e studentëve në strukturat vendimarrëse në institucion dhe departament shton mundësinë e marrjes së mendimit të studnetëve përmes diskutimeve dhe anketimeve sugjerimet e të cilëve reflektohen në ndryshimet që bëhen në lëndë të veçanta.</i> <i>GVJ-ja rekomandon realizimin e praktikës profesionale në institucione të tjera jashtë KU "Bedër", çka do të ndikonte në cilësinë e programit të studimit duke tërhequr mendimin e palëve të treta dhe duke qenë vazhdimisht në korrent të ndryshimeve të kërkesave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ-ja konstaton se rregullorja e programit të studimit i ka të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat formuese të studimit. Në nenin 3 të kësaj rregulloreje thuhet se programi i Masterit Shkencor në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" studion zhvillimin historik të gjuhës Angleze, marrëdhëniet midis gjuhës dhe të menduarit, marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës. Programi përbëhet prej lëndëve të avancuara në letërsinë dhe kulturën Angleze dhe nga lëndët kërkimore. Nenet 15-17 të kësaj rregulloreje, përcaktojnë kushtet e shkrimit të tezës dhe mbrojtjes së saj. Përveç kësaj, objektivat e kërkimit shkencor në këtë program janë në përputhje me objektivat e institucionit. Në planin strategjik të institucionit, Kapitulli II, përcaktohen synimet për të arritur përsosmërinë në kërkimin shkencor, integrimin e tij në edukim, përmirësimin e konkurrencës të kërkimit shkencor dhe zgjerimin e partneriteteve, inovacionit dhe sipërmarrjes. (Evidenca nr. 9: Plani Strategjik Institucional 2018-2023; Evidenca nr. 10: Plani Strategjik Institucional 2024-2028).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit,	Referuar shqyrtimit të DVV-së si dhe takimeve me drejtuesit e njësive kryesore dhe njësive bazë, GVJ-ja konstaton se Statuti Themelor, dhe

bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	rregulloret e institucionit, fakultetit dhe departamentit të Edukimit dhe gjuhës angleze rregullojnë bashkërendimin dhe administrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe veprimtarive kërkimore. Një rol të rëndësishëm i kushtohet lirisë akademike të personelit akademik në fushën e studimit. Për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë të stafit akademik në veprimtari akademike dhe shkencore, institucioni nxjerr jo vetëm udhëzime, por edhe një mbështetje sa më të gjerë financiare. (Evidenca nr. 33: Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor; Evidenca nr. 34: Procedura e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU "Bedër"; Evidenca nr. 85: Procedura për Mbështetjen Financiare të PA për Kërkimin Shkencor)
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Referuar të dhënave në RVB dhe materialeve informuese në DVV, GVJ-ja vëren se programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve në studime, projekte dhe aktivitete studimore nëpërmjet realizimit të aktiviteteve shkencore, konferencave, leksioneve të hapura etj. 7 studentë janë aktivizuar në punime shkencore individuale të pedagogëve të tyre. Gjithashtu, në raportin vjetor të departamentit për vitin 2022-2023 dokumentohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitete kombëtare dhe trajnime të ndryshme në fushën e kërkimit shkencor. (Evidenca nr. 35: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2022-2023).
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Mbështetur në dokumentacionin e DVV-së GVJ-ja konstaton se institucioni ofron mbështetje të vazhdueshme për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore në nivel njësie bazë duke i mbështetur financiarisht. Në rregulloren themelore të institucionit përcaktohet qartë se për çdo botim dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare stafi akademik mbështetet financiarisht nga vetë institucioni. Për këtë arsye, çdo vit njësia bazë përcakton dhe dorëzon në njësitë përkatëse projekt buxhetin e tij ku një nga pikat kryesore është dhe mbështetja financiare për realizimin e aktiviteteve të saj në fushën studimore dhe kërkimore. (Evidenca nr. 33: Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor; Evidenca nr. 34: Procedura e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU "Bedër"; Evidenca nr. 85:




	Procedura për Mbështetjen Financiare të PA për Kërkimin Shkencor) (Evidenca nr. 47: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” i ka të përcaktuara qartë në rregulloren e tij prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor. Mbështetur në objektivat e përcaktuara në planin strategjik të institucionit për kërkimin shkencor, njësia kryesore dhe njësia bazë bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimore. Për të arritur këto objektiva, njësia bazë angazhon studentët në studime, projekte dhe veprimtari kërkimore si dhe stafin akademik duke ofruar dhe ndihmë financiare për këto veprimtari.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Në planin strategjik të institucionit për vitin 2024-2028 GVJ-ja konstaton se një pikë e rëndësishme është dhe kërkimi shkencor. Për këtë arsye, janë marrë të gjitha masat për të siguruar një mbështetje të vazhdueshme financiare (Evidenca nr. 21: Rregullorja mbi Projektet Kërkimore Shkencore). Për një realizim sa më cilësor të objektivave të programit të studimit në fushën e kërkimit shkencor, GVJ-ja konstaton nga dokumentacioni në DVV dhe biseda me drejtuesen e njësisë bazë se kjo njësi organizon në mënyrë periodike konferencën e saj ICESS, leksione të hapura me profesionistë të fushës dhe aktivitete të tjera të realizuara në bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore. Nga takimi me drejtuesen e departamentit dhe dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Drejtësisë, GVJ-ja konstaton se njësia kryesore bashkëpunon me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve të

	ndryshme, konferencave, projekteve dhe bashkëpunimeve me synim përmirësimin e programit të studimit (Evidenca nr. 75: Projekti EMI). <i>GVJ-ja konstaton se brenda departamentit nuk ka ndarje në grupe lëndore sipas fushave të studimit dhe kërkimit shkencor.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Referuar DVV-së, planit strategjik të KU "Bedër", takimit me stafin, me drejtuesen e departamentit dhe dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane konstatohet bashkëpunime me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj për organizmin dhe zhvillimin e trajnimeve të ndryshme, konferencave, projekteve dhe bashkëpunimeve me synim përmirësimin e programit të studimit. Tabela nr.19 eidenton se në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë gjatë 5 viteve të fundit janë fituar 3/1 projekte dhe zbatuar 2/2 të tilla. (Evidenca nr. 3- Planit strategjik UAMD 2020 - 2025; Evidenca nr.23 - Planit strategjik i zhvillimit të programit të studimit; Evidenca nr.123 – Marrëveshje bashkëpunimi për programin Erasmus; Takimet në institucion).
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Referuar të dhënave në RVB dhe materialeve informuese në DVV, GVJ-ja vëren se njësia bazë organizon konferenca shkencore ndërkombëtare periodike në fushën e programit të studimit (ICESS). Gjatë 5 viteve të fundit në shërbim të programit të studimit janë realizuar në nivel njësie bazë 32 botime shkencore ndërsa janë organizuar 3 aktivitete shkencore nga departamenti dhe 4 nga fakulteti (Tabela nr.19). Njësia kryesore realizon jo vetëm konferenca ndërkombëtare por siguron edhe botime periodike në revistën shkencore (BJH) pa detyrime financiare. Në këto konferenca marrin pjesë si stafi akademik ashtu dhe studentët.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, GVJ-ja konstaton se kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" është hartuar mbi bazën e përvojës së universiteteve të tjera homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Objektiva kryesore e këtij programi është formimi i specialistëve në fushën e filologjisë dhe gjuhësisë. GVJ-ja vëren se nga viti 2020-2021 janë diplomuar në këtë program 6 studentë, 2021-2022 janë diplomuar 3 studentë ndërsa për vitin 2022-2023 8 studentë nga të cilët 83%, 100% dhe 88% janë punësuar.

	(Evidenca nr. 59: Raport i Zyrës së të Diplomuarve).			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	GVJ-ja konstaton nga dokumentacioni në DDV se programi i studimit i ofruar nga departamenti i Edukimit dhe Shkencave Humane është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, udhëzimeve të MAS si dhe VKM-ve përkatëse. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike në këtë program hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian. Kjo prek në mënyrë të veçantë kërkimin shkencor, i cili është i mbështetur gjerësisht nga institucioni përmes urdhërësive për nxitjen e tij dhe ndihmës financiare të ofruar stafit akademik. Njësia kryesore dhe ajo bazë angazhohen vazhdimisht në studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor, ku përveç stafit përfshihen dhe studentët. Në fushën e programit të studimit njësia bazë organizon periodikisht konferencën shkencore ndërkombëtare (ICESS), ndërsa njësia kryesore realizon publikime periodike të stafit në revistën shkencore BJH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ-ja konstaton se bazuar në dokumentacionin e përfshirë në DVV, programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është i organizuar me 120 kredite sipas sistemit “European Credit Transfer System, (ECTS) dhe realizohet me kohë të plotë në dy vite akademike të ndara në katër semestra. GVJ-ja konstaton se në përputhje me VKM 41/2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë format kryesore të mësimdhënies përfshin leksione, seminare, praktikë, diploma ose provim formimi, ndërsa format e mësimnxënies janë: detyra kursi ose projekte, të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullarët e lëndëve, si një mënyrë që i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve për punën në grup, marrjen e iniciativave individuale, nxitjen e mendimit kritik dhe zbatimin e punëve me karakter aplikativ dhe praktik. Nga vizita në institucion GVJ-ja konstatoi se personeli akademik e realizon procesin mësimor në forma audio-vizuale nëpërmjet infrastrukturës dhe hapësirave digjitale që ofron Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, të tilla si: auditore të pajisura me smart-board dhe projektorë, gjë që mundëson kalimin më cilësor të njohurive të studentit, salla për aktivitete promovuese, laboratorë informatike, biblioteka fizike, biblioteka online, platforma BIS. Në raportin e departamentit për vitin 2022-2023 vihet re se njësisia bazë ka organizuar leksione të hapura, workshope dhe konferenca, të cilat mbështesin procesin e mësimdhënies. (Evidenca nr. 93: Leksione të Hapura me Akademikë dhe Figura të Letrave); (Evidenca nr. 35: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2022-2023; Evidenca nr.17: Syllabus-et e Lëndëve të Programit).

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Referuar RVB-së dhe informacionit të paraqitur në DVV, si dhe takimit me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, GVJ-ja konstaton se personeli akademik ofron forma, mënyra dhe metoda alternative të mësimdhënies për tju përgjigjur nevojave të studentëve. Përditësimi i përvitshëm i sillabuseve është një mënyrë për realizimin e tyre. Nga biseda me studentët rezulton se pedagogu realizon orë shtesë dhe konsultat sipas nevojave të tyre. Stafi mban kontakt të vazhdueshëm me studentët si fizikisht ashtu dhe në formë elektronike përmes emailit, platformave online të mësimdhënies si BIS, google classtoom, google drive etj. Pedagogët janë pjesë e programeve të shkëmbimit në universitete partnere, ku ata kanë kryer mobilitete për qëllime mësimdhënëse ose trajnimi. (Tabela 10, Evidenca nr.17: Syllabus-et e Lëndëve të Programit)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Referuar RVB-së dhe materialeve informuese në DVV, GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” organizon aktivitete trajnimi periodike për personelin akademik, lidhur me përmirësimin e kompetencave didaktike kryesisht në drejtim të përdorimit të metodave inovative në mësimdhënie Pjesëmarrja në programet evropiane të shkëmbimit të stafit në universitete partnere dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga njësia bazë dhe të financuara nga institucioni i shërbejnë këtij qëllimi. GVJ-ja konstaton se institucioni i kushton vëmendje të vecantë përmirësimit të infrastrukturës në shërbim të personelit akademik (mjete dixhitale të avancuara, kompjutera, akses në llogari elektronike në sistemin BIS, biblioteka dixhitale dhe fizike) për të siguruar përmirësimin e kompetencave didaktike. (Evidenca nr. 76: Lista e Trajnimeve të Organizuara për Stafin, 2020-2023; Evidenca nr. 27: Plani i Trajnimeve të Personelit; Evidenca nr. 75: Projekti EMI), (Vizita në institucion; Tabelat permbljedhese 16-17-19).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe	GVJ-ja konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” për vitin akademik 2023-2024 përbëhet nga profesorë të arsimuar brenda dhe jashtë vendit, në total nëntë (9), të gjithë (9) personel akademik efektiv (PAE). Përsa i përket kualifikimeve të personelit




koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	akademik efektiv, GJV-ja konstaton se për vitin akademik 2023-2024 personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, përbëhet nga (2) Profesorë të Asociuar; (5) Doktorë të Shkencave; (1) MSc në process doktrature dhe një (1) MSC (Shtojca 1-Tabelat 7). GJV-ja konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është i formuar në gjuhën angleze dhe specializuar në drejtime të ndryshme: Studime Angleze dhe Amerikane, Shkenca Sociale me profil Psikologji-Pedagogji, Shkenca Politike, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (Evidenca nr. 16: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit). GJV-ja konstaton se departamenti siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes studentëve duke praktikuar mësimdhënien me në qendër studentin duke u dhënë atyre mundësinë të shprehin idetë e tyre përmes prezantimeve, projekteve, detyrave të kursit, aktiviteteve sociale të reflektuara në planin vjetor të departamentit të cilat synojnë krijimin e një marrëdhënie të fortë mes pedagogëve dhe studentëve. (Evidenca nr. 50: Plani i Aktiviteteve te Departamentit, 2023-2024).
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GJV-ja konstaton se Statuti i KU “Bedër” parashikon në nenin 28 Kreu VIII përfshirjen e studentëve në proceset e vlerësimit të cilësisë së brendshme (Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”). Për të monitoruar në mënyrë efikase cilësinë e mësimdhënies institucioni përfshin edhe studentët në vlerësimin e metodave të mësimdhënies duke përdor si instrument Pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës. Ky pyetësor aktivizohet në sistemin BIS dy herë në vit: në fund të çdo semestri para fillimit të provimeve përfundimtare dhe para reflektimit të vlerësimit përfundimtar të lëndës në sistem. Në këtë pyetësor studenti vlerëson performancën e pedagogut në 5 drejtime: përpikmërinë e pedagogëve, përgatitjen e tyre për lëndën, njohuritë mbi lëndën, literaturën, ndërveprimin me studentët dhe metodat e mësimdhënies.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	Për të garantuar ruajtjen e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit KU “Bedër” ka ngritur struktura të posaçme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë në nivel institucional dhe të programeve të studimit si psh., Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale dhe për përmirësimin e

mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	vazhdueshëm të mësimdhënies si Njësia e Sigurimit të Cilësisë, në përbërje të të cilës përfshihet edhe një (1) student. Misioni i NJBSC-së i përcaktuar në rregulloren e saj përqendrohet rreth aplikimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë eksplicite procesin e mësimdhënies, të nxënit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studentëve me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me në qendër studentin. NjSBC-ja në bazë të sugjerimeve dhe propozimeve të mbledhura përmes anketimeve të kryera nga studentët në lidhje me përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimit të realizuar nga titullari i njësisë për stafin akademik koordinon punën me departamentin dhe burimet njerëzore për të organizuar trajnime në shërbim të stafit akademik.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "Bedër" e realizon procesin e mësimdhënies, aftësimit profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin duke rekrutuar personel akademik të paisur me grada shkencore të nevojshme për mësimdhënien në ciklin e dytë të studimeve për programin Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze". GVJ-ja konstaton se në përgjithësi specializmi i stafit akademik përkon me fushën e lëndës që mbulon. Për të garantuar sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe përdorimin e metodave interaktive që nxisin mendimin krijues dhe atë kritik, institucioni ka ngritur strukturat e sigurimit të cilësisë së brendshme, ku janë përfshirë edhe studentët. Raportimi i të dhënave të mbledhura nga anketimet e studentëve i jepen të detajuara çdonjërit prej lektorëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB-së, GVJ-ja konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale për programin e

aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” janë të përcaktuara bazuar në kuadrin rregulator të brendshëm të institucionit si psh., rregullorja e institucionit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit të studimit si dhe rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë. Në këto rregullore parashikohen procedurat dhe kriteret e vlerësimit, të cilat pasqyrohen në Guidën e studentit, i cili publikohet në faqen zyrtare të KU “Bedër”. Këto informacione u bëhen të ditura studentëve edhe përmes marrëveshjes që nënshkruajnë me institucionin, sikurse dhe te syllabuset e lëndëve. Sistemi i vlerësimit të studentit, i lejon pedagogut të përdorë lirinë akademike dhe sipas natyrës së lëndës të zgjedh mes formave të unifikuara dhe përqindjes për secilën prej tyre. (Evidenca nr. 56: Model Kontrate me Studentin; Evidenca nr. 30: Guida e Studentit; Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 4: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ-ja konstaton nga Evidenca nr.17: Syllabus-et e Lëndëve të Programit dhe vizita në institucion me studentët dhe personelin akademik, se studentët informohen mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Ky informacion i bëhet i ditur studentëve që në fillim të semestrit nga pedagogu dhe gjenden elektronikisht në sistemin BIS ku kanë akses si studentët edhe pedagogët.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ-ja konstaton se format e kontrollit të njohurive si dhe përqindjet për çdo formë vlerësimi janë të përcaktuara qartë dhe të ndara në përqindje (Tabela 15, shtojca nr.1): • pjesëmarrja aktive e studentëve (0-15%); • plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyra kursi) (10-30%); • testime gjatë vitit (20-50%); • provim përfundimtar (30-60%). GVJ-ja konstaton se kjo ndarje mes kategorive të vlerësimit është reflektuar edhe në syllabuset e lëndëve, të cilët përcaktojnë edhe kategorinë për frekuentimin e detyrueshëm të lëndës, e cila nuk


	duhet të jetë më pak se 75% dhe zë peshë në vlerësimin përfundimtar të lëndës nga 0-15%.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "Bedër" rekruton personel akademik me grada shkencore të nevojshme për mësimdhënien në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze".</i> <i>Nga shqyrtimi i CV-ve, GVJ-ja konstaton se në përgjithësi ka përputhje mes specializimit të personelit akademik në program dhe grupit të lëndëve që ata mbulojnë. Në tërësi, në program përdoren metoda dhe praktika me në qendër studentin që nxisin mendimin krijues dhe atë kritik të cilat mbështeten prej institucionit përmes trajnimit të personelit akademik dhe përfshirjes së tyre në programet e mobilitetit.</i> <i>GVJ-ja konstaton se institucioni ka ngritur mekanizma për vlerësimin e brendshëm të cilësisë duke siguruar edhe përfshirjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ-ja konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive për programin e studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" realizohet përgjatë gjithë semestrit për çdo lëndë. Kategoritë e vlerësimit janë në përputhje me rregulloren e KU "Bedër" dhe VKM 41, dt. 24.1.2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL". Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij programi studimi sipas rregullores së institucionit kërkon detyrimisht zhvillimin e një provimi gjysmëfinal dhe një provimi përfundimtar. Në syllabuset e lëndëve tregohet mënyra e realizimit të vlerësimit përfundimtar dhe përqindjet për çdo formë vlerësimi, i cili është rezultat i tre treguesve: 1-provimi përfundimtar/final zë 30-60% të vlerësimit; 2-testimi gjatë vitit (provimi i ndërmjetëm) zë 20-50 % ; 3-detyrat e kursit, projektet, prezantime, artikuj kërkimore, punë në grup kuize zënë 10-30 % të vlerësimit përfundimtar; 4-ndërsa pjesëmarrja dhe aktivizimi në orën mësimore zë peshë në vlerësimin përfundimtar të lëndës nga 0-15% ¹ . Sistemi i pikëzimit të tyre është reflektuar në syllabuset e lëndëve, ku është përcaktuar gjithashtu kategoria e

	frekuentimit të detyrueshëm të lëndës, e cila nuk duhet të jetë më pak se 75%. (Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar informacionit në RVB, institucioni përdor sistemin e brendshëm BIS për komunikimin e rezultateve të provimit për çdo lëndë por edhe për të realizuar testime në formë elektronike. Nga takimi me personelin akademik, GVJ-ja konstaton se platforma “Google Classroom” përdoret nga personeli akademik për të realizuar një vlerësim automatik sipas rubrikave të caktuara ku përcaktohet dhe pikëzimi, çka i shërben transparencës në vlerësim. Me qëllim shmangien e plagjaturës në punimet, detyrat e kursit, artikujve dhe tezave, institucioni ka vendosur në dispozicion të personelit akademik sistemet e plagjaturës PlagiarismSearch, Turnitin etj. (Dy linqet e referuara në RVB).
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ-ja konstaton nga dokumentacioni në DVV, se format e kontrollit të njohurive dhe pikëzimi i tyre, janë parashikuar qartë nga pedagogu në syllabuset e lëndëve në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”. Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij programi studimi kryhet në bazë të shumës së pikëve të grumbulluara përgjatë vitit dhe është rezultat i katër (4) treguesve: 1-testimi i ndërmjetëm, 2-zhvillimi i projekteve, eseve, detyrave të kursit; 3-testimi përfundimtar; 4-frekuentimi. <i>GVJ-ja konstaton prej programeve të lëndëve të përfshira në DVV, se format vlerësimit të dijeve të miratuara në rregullore nuk respektohen në të gjitha syllabuset.</i> <i>Gjithashtu, GVJ-ja konstaton se vlerësimi përfundimtar sipas pikëve të grumbulluara (në total 100 pikë) nuk është i mirëpërcaktuar në formë tabelare, ndaj GVJ-ja rekomandon që në syllabuset e lëndëve të përfshihet jo vetëm mënyra e vlerësimit të dijeve, por edhe konvertimi i përqindjes të grumbulluar të shprehur në gërmë apo notë sipas sistemit Amerikan dhe Shqiptar të vlerësimit.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Referuar takimeve në institucion me personelin akademik dhe studentët, GVJ-ja konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin e studimit në Master i Shkencave



shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” shoqërohet me komentet përkatëse, sqarimin e përgjigjeve të sakta si dhe me çelësin e provimit. Pedagogu në varësi të nevojave të studentëve organizon para provimit takime ose orë shtesë për të ndihmuar përvetësimin e njohurive më me efikasitet. Përgjatë semestrit, pedagogu shoqëron procesin mësimor me një vlerësim të vazhduar joformal, duke u dhënë studentëve feedback me gojë ose shkrim, diskutimin e temave të ndryshme si dhe shqyrtimin dhe rishqyrtimin e eseve apo artikujve para dorëzimit të tyre.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga bisedat në institucion, RVB-ja dhe dokumentacioni në DVV, evidentohet nga GVJ-ja shmangia dhe mos lejimi i plagjiaturës, si dhe mos kopjimi në provime dhe detyra kursi. Institucioni ka hartuar Rregulloren për disiplinën e studentëve në të cilën parashikohet dënimi për plagjiaturën ose kopjen. Ky rregull përforcohet edhe në syllabuset e lëndëve ku theksohet detyrimi për të respektuar rregullat e etikës të përcaktuara në Rregulloren për disiplinën e studentëve. Në rast dyshimi për kopje ose plagjiaturë, ngrihet një komision disiplinor dhe për çdo shkelje rregullash të lidhura me organizimin e provimeve studenti mban përgjegjësi. Kontrolli i plagjiaturës në punime bëhet përmes sisemit PlagiarismSearch pa pagesë për personelin akademik. (Evidenca nr. 26: Rregullorja e Disiplinës së Studentëve).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ-ja konstaton nga informacioni i paraqitur në RVB, se afatet e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale shpallen në kalendarin akademik në fillim të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen e KU “Bedër” dhe në sistemin e brendshëm BIS. Studentët vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit të paraqitur në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi bëhet në bazë të meritës duke reflektuar një kombinim formash të vlerësimit të folur dhe të shkruar, vlerësimi formal dhe jo formal, të vazhdueshëm dhe përfundimtar. Rezultatet e studentëve pasqyrohen në sistemin e brendshëm BIS. Nga RVB-ja, GVJ-ja konstaton se dosja e provimit në përbërje të së cilës gjenden: fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje e pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare dorëzohen nga pedagogu i lëndës sipas rregullores përkatëse. (Evidenca nr. 61: Kalendari Akademik “Master”; Evidenca nr. 29: Guida e Stafit; Evidenca nr. 30: Guida e Studentit; Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë; Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”).

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ-ja konstaton se rregullorja e programit të studimit u garanton studentëve të drejtën të njihet me vlerësimin e provimeve të realizuara sipas afateve të përcaktuara në kalendarin akademik. KU "Bedër" përdor sistemin e brendshëm BIS për publikimin e rezultateve të vlerësimit për çdo lëndë. Rregulloret e këtij institucioni garatojnë të drejtat e studentëve jo vetëm për t'u njohur me vlerësimin, por edhe për të kryer kërkesa për rishikim të vlerësimit në rast mosdakortësie. GVJ-ja konstaton se neni 102 i Rregullores Themelore të KU "Bedër" parashikon ankimimin e provimeve, ku si procedurë studenti i drejton ankesën me shkrim zyres së sekretarisë mësimore një javë nga dita e publikimit të rezultateve. Pasi drejtuesi i njësisë kryesore njihet me ankesën, ai ngre një komision për rishikimin e saj. Rishikimi i tezës bëhet nga një komision prej tre vetash ku pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë. Vendimi i komisionit i bëhet të ditur studentit brenda 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. (Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"; Evidenca nr. 87: Procedurë për Ankimimin e Notës).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Rregullorja e provimeve për ciklin e dytë garanton të drejtat e studentëve jo vetëm për t'u njohur me vlerësimin, por edhe për të kryer kërkesa për rishikim të vlerësimit në përputhje me këtë rregullore. Procedura e ankimimit parashikon paraqitjen e kërkesës me shkrim nga ana e studentit te zyra e sekretarisë mësimore, jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga publikimi i rezultatit. Pasi drejtuesi i njësisë kryesore njihet me ankesën, ai ngre një komision me tre vetë për rishikimin e saj. Vendimi i bëhet i ditur jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Vendimi dhe vlerësimi i komisionit dokumentohen dhe arkivohen pra (Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë) ,(Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU "Bedër" ka hartuar një kuadër rregullator të konsoliduar, ku përfshihen rregulloret të përgjithshme (Rregullorja Themelore e Institucionit, Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë) për të garantuar vlerësimin transparent të studentit duke i dhënë studentit të drejtën të realizojë procedurën e ankimimit të notës sipas procedurës të parashikuar në këto rregulloret. GVJ-ja evidenton se KU "Bedër" ofron mundësinë e vlerësimit fizik, por edhe në formatin elektronik përmes sistemit të brendshëm BIS. Ky</i>




	system përdoret edhe për të publikuar rezultatet e vlerësimit përfundimtar për çdo lëndë. Institucioni ka marrë masat për të parandaluar kopjen apo plagjiaturën duke vendosur falas në dispozicion të personelit akademik PlagiarismSearch dhe Turnitin, si dhe masave ndëshkuese për rastet e shkeljeve, të cilat janë të parashikuara në rregullore, ndaj GVJ-ja e konsideron këtë standard të përmbushur plotësisht. GVJ-ja rekomandon realizimin e vlerësimit përfundimtar brenda përqindjeve të secilës prej formave të vlerësimit që janë të miratuara në rregulloren përkatëse si dhe prezantimin e vlerësimit të dijeve në sillabus, jo vetëm me përqindje por edhe me konvertimin në gërmë apo notë sipas sistemit Amerikan dhe Shqiptar të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Nga takimi me drejtuesin e njësisë bazë, GVJ-ja konstatoi se nga momenti i hapjes plani mësimor i programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është ndryshuar vetëm një herë, ku lënda ELL, 510 me 30 kredite u bë ELL Tezë me 18 kredite dhe ELL 550 Praktikë me 12 kredite. Ky program mundëson thellimin e njohurive në studime letrare dhe kulturore. GVJ-ja konstaton se orët e studimit individual, të cilët përlogaritin veprimtarinë e përgatitjes së punimeve, detyrave të kursit dhe projekteve, (parashikuar në VKM 41/2018) janë përfshirë në planin mësimor të programit të studimit, të shpërndara sipas kategorive orë në auditor, studim individual dhe provime. Lëndët e planit mësimor, tema e diplomës dhe praktika profesionale i pajisin studentët me njohuri e aftësi të thella në fushën kërkimore dhe kompetenca në fushën e letërsisë dhe kulturës angleze.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,	GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në studime letrare dhe kulturore.

humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<i>Duke qenë se nga dita e hapjes e në vazhdim, programi nuk ka kaluar asnjë riorganizim, GVJ-ja rekomandon riorganizimin e kurrikulës së programit për ta bërë atë më bashkëkohore në mënyrë që kompetencat që studentët mendohet të fitojnë në këtë program tu përshtaten më mirë ndryshimeve në kërkesat e tregut të punës.</i> <i>GVJ-ja rekomandon që kurrikula e programit të rishikohet për ta pasuruar më lëndë ndërdisiplinore, të cilat do t'i ndihmonin studentët të formoheshin në fushën e teknologjisë së informacionit, tashmë një domosdoshmëri e pashmangshme, por edhe në fusha të tjera të edukimit ndërkulturor çka do t'i bënte studentët të aftë të punojnë në kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Referuar RVB-së dhe takimit me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, GVJ-ja konstaton se personeli akademik me anë të metodave vlerësuese që aplikon, teston masën e plotësisht të objektivave të shprehura në syllabuset e lëndëve. Më konkretisht, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Titullari i lëndës, në përfundim të semestrit, organizon një diskutim të lirë me studentët, ku ata shprehin mendimet e veta mbi njohuritë dhe shprehitë e fituara, mbi bazën e të cilave pedagogu del në përfundime për përmirësimin në të ardhmen. Për përvetësimin sa më efikas të temave të parashikuara në syllabus, pedagogu parashikon prezantimin e projekteve individuale dhe praktikave profesionale.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të	GVJ-ja konstaton se prezantimi i detyrave të kursit, projekteve, eseve, për të cilat KU “Bedër” ka vënë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme, siç janë laboratorët kompjuterikë si dhe praktika profesionale, mundësojnë realizimin e një mësimdhënie me bazë kompetencash, sikurse reflektohet edhe në sillabuset e lëndëve. Metodologjia e përdorur nga stafi akademik është bashkëkohore e përshtatur me institucionet brenda dhe jashtë vendit, tek disa anëtarë të stafit kanë qëndruar në kuadër të programeve të mobilitetit. Nga diskutimet me studentët dhe RVB-ja vihet re se institucioni mbështet studentët në zhvillimin e aftësive të tyre përmes punës në grup, ku ata kanë mundësinë e ndarjes së ideve dhe zhvillimit të ideve inovatore. Njohja e

përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	studentëve me studime të fundit në fushën kërkimore si dhe metodologjia bashkëkohore e përshtatur me atë të institucioneve të tjera homologe me të cilat institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi rrit mundësitë e studentëve për mobilitet.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ-ja konstaton se në fillim të çdo viti akademik njësia bazë harton një plan aktiviteteve si psh., seminare trajnuese, workshope, leksione të hapura të cilat i shërbejnë krijimit të një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve dhe përmirësimit të veprimtarive mësimore. Në referencë me planin e aktiviteteve të departamentit për vitin akademik 2023-2024 si konferenca, trajnime, të ftuarit etj., bëhen të hapura dhe lejohet pjesëmarrja e studentëve, specialistëve të fushës së letrave dhe akademikëve nga jashtë dhe brenda vendit. (Evidenca nr. 50: Plani i Aktiviteteve të Departamentit, 2023-2024; Evidenca nr. 93: Leksione të Hapura me Akademikë dhe Figura të Letrave; Evidenca nr. 80: Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Eoei Hung, bashkë me linqet përkatëse).
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” ka pjesë përbërëse të planit të tij strategjik rritjen e mundësisë dhe përvojave ndërkombëtare të studentëve. Studentët mbështeten nga institucioni për idetë e tyre inovative dhe kërkimore duke u mundësuar realizimin e detyrave sipas lëndëve që frekuentojnë, nxitjen e tyre për tu përfshirë në projekteve përfshirëse apo individuale si dhe pjesëmarrjen në konferenca studentore ndërkombëtare, etj. GVJ-ja eidenton se studentët e programit kanë marrë pjesë si autorë në konferencën ndërkombëtare ICESS të organizuar nga njësia bazë pa asnjë pagesë. (Evidenca nr. 96: Rast i Pjesëmarrjes së Studentëve në Konferencë me Mbështetjen e KUB). (Evidenca nr. 34: Procedura e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU “Bedër”).
Konkluzione	<i>Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”</i>





	garantohet nga parashikimet dhe përcaktimet në rregulloren e institucionit dhe programit të studimit, si dhe planin e veprimtarisë mësimore –shkencore të departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze. Për të siguruar përmirësimin e cilësisë së programit të studimit në fund të çdo semestri analizohet niveli i përfitimit të kompetencave. Gjithashtu, institucioni organizon me specialistë të fushës së letrave dhe akademikë nga jashtë dhe brenda vendit workshop-e, konferenca, leksione të hapura etj, ku lejohet pjesëmarrja e studentëve. GVJ-ja konstaton se njësia bazë është e angazhuar dhe i kushton kujdes formimit tërësor të studentëve dhe pajisjes së tyre me aftësi profesionale dhe aftësi të veçanta për tu formuar si profesionistë në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze në institucionet e arsimit të lartë si dhe në drejtime të lidhura me kulturën dhe letërsinë angleze, të aftë për tju përshtatur kërkesave të tregut të punës. GVJ-ja rekomandon përditësimin dhe përmirësimin e kurrikulës dhe programeve lëndore. Kjo nënkupton shfrytëzimin e mundësisë për të bërë ndryshimin e kurrikulës në masën 20% sipas Udhëzimit Nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë (ndryshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020) duke e pasuruar kurrikulën e programit me lëndë më konkurruese për kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato	GVJ-ja konstaton se institucioni ka hartuar qartësisht procedurat për detyrimet përmbyllëse të studimeve, të cilat janë të saksionuara në rregulloret e tij të brendshme (Përmbyllja e studimeve për programin e studimit në Master i Shkencave në

publike dhe e bën atë publike.	“Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, kryhet me punim diplome. Teza e programeve “Master i shkencave” me 120 ECTS ka vlerë jo më shumë se 15% të krediteve totale të programit, pra 18 ECTS (neni 39, Rregullorja e studimeve dhe provimeve të Ciklit të dytë). Kjo rregullore ka parashikuar elementët e lidhura me shkrimin e tezës së diplomës si psh, teza e diplomës mbrohet vetëm në rast se studenti ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike të programit; udhëheqja e punimit të diplomës të realizohet nga personel i stafit akademik që kanë titull ose gradë shkencore së paku “Doktor”; studenti regjistron temën në fillim të semestrit të fundit, etj. Studenti njihet që në fillim të programit me formën e detyrimeve përmbyllëse. (Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”; Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” bën publik gjithë informacionin rreth provimeve finale dhe mbrojtjes së punimeve të tezës GVJ-ja konstaton se udhëheqësit e diplomave kanë një rol të rëndësishëm në përcjelljen e këtij informacioni. Manuali i përgatitjes së tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit, gjenden në Manualin për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë. (Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë). (Evidenca nr. 72: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	GVJ-ja konstaton se punimi i tezës së diplomës është i përfshirë në planin mësimor të programit si lëndë e detyrueshme në semestrin e katërt. Për administrimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomës, ngrihet një komision i posaçëm/ juria me jo më pak se tre (3) persona (një nga të cilët është udhëheqësi i tezës). Kohëzgjatja e mbrojtjes së tezës është jo më pak se 45 minuta

modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	dhe jo më shumë se 90 minuta, duke përfshirë dhe pjesën e provimit me gojë pyetje-përgjigje. Komisioni i ngritur bën vlerësimin e tezës sipas peshës specifike të elementëve të vlerësimit të tezës.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ konstaton se teza e diplomës udhëhiqet nga punonjësit mësimorë- shkencorë të njësisë kryesore që kanë titull ose gradë shkencore Doktor. Përveç udhëheqësit të diplomës një rol të rëndësishëm ka dhe këshilltari akademik, i cili informon studentët për çdo detyrim në prag të diplomimit (Evidenca nr. 64: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik). Udhëheqësi i temës së diplomës luan një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e temës, strukturimin e saj, aplikimin e metodologjisë, nxjerrjen e përfundimeve dhe literaturën e referuar nga studenti, të cilat vlerësohen prej tij në sipas kriterëve të parashikuara në formularin e vlerësimit (Evidenca nr. 71: Formular i Ecurisë së Tezës.)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga dokumentacioni i përfshirë në DVV, GVJ-ja konstaton se përfshirja e udhëheqësit akademik në testet e realizuara nga studenti, matja e të dhënave, analiza e tyre si dhe koha e plotësimit është e rëndësishme. Formulari i ecurisë së tezës që plotësohet prej udhëheqësit të temës, përmban katër kriterë vlerësimi, të cilat dëshmojnë angazhimin e udhëheqësit të temës në këtë proces. Për shkrimin e tezës së diplomës dhe provimet gjysëm dhe finale, institucioni vendos në dispozicion të studentëve laboratorin e kompjuterave dhe bibliotekat të cilat qëndrojnë hapur edhe në fundjavë.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi përfundimtar i tezës së diplomës ose mbrojtja e diplomës realizohet me notë, e cila shfaqet në listën e notave të studentit. Komisioni miratohet nga departamenti dhe përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, të cilët janë specialist në fushën e tezës që mbron studenti.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të	GVJ-ja konstaton se në përfundim të studimeve, studenti i cili ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e parashikuara në kurrikulën e programit të studimit dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria




studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	përgjegjëse për arsimin Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”. GVJ verifikoi gjatë vizitës në sekretarinë mësimore se me kërkesën e studentit në përfundim të studimeve, institucioni i vë në dispozicion kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit. Evidenca nr. 104: Diploma dhe Suplementi). (Evidenca nr. 20: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi për një periudhë kohore kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Dokumentacioni i procesit mësimor përfshin ruajtjen e të dhënave të studentëve dhe lëshimin e diplomave dhe certifikatave në përputhje me ligje në fuqi. (Evidenca nr. 32: Rregullorja e Arkivës).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, kryhet me mbrojtje të punimit të diplomës, procedurë e cila është parashikuar në rregullore të posaçme, “Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë”. Studenti duhet të grumbullojë 120 kredite (ECTS) (18 kredite (ECTS) për mbrojtjen e diplomës) për të përmbushur detyrimin përmbjellës të diplomimit. Koordinator i programit të studimit i propozon dekanit të Fakultetit udhëheqësit e temave për çdo student dhe në fillimin e semestrit të katërt u bëhen të ditura studentëve kriteret dhe procedura e diplomomit nëpërmjet tezës së diplomës, të cilat studenti i gjen edhe në faqen e institucionit dhe në kontaktet që ka me këshilltarin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar Tabelës 7 të shtojcës nr.1 dhe dokumentacionit në DVV, nga GVJ-ja konstatohet se programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” për të paktën tre vitet e fundit akademike mbulohet nga personel akademik me kohë të plotë. Personel akademik me kohë të pjesshme nuk ka të angazhuar në program. Në total janë 9 personel akademik (PAE) i angazhuar në programin e studimit nga të cilët dy (2) janë Profesorë të Asociuar; pesë (5) Doktorë të Shkencave; dhe dy (2) MSc ku njëri është në process doktorature. Nga CV-të e stafit akademik dhe orientimi i studimeve të tyre pasuniversitare, GVJ-ja konstaton se në masën më të madhe, fusha kërkimore dhe specializimi i tyre është në përputhje me natyrën dhe specifikat e lëndëve dhe moduleve që mbulojnë.					
	Personeli i angazhuar për programin e studimit	2021-2022		2022-2023		2023-2024
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE PAK
		Prof Dr	-	-	-	-
	Prof.Assoc	1	-	1	-	2 -

	<table><tr><td>Dr/Doc</td><td>4</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>1</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>6</td><td>0</td><td>8</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td></tr></table>	Dr/Doc	4	-	5	-	5	-	Msc	1	-	2	-	2	-	Në total	6	0	8	0	9	0
Dr/Doc	4	-	5	-	5	-																
Msc	1	-	2	-	2	-																
Në total	6	0	8	0	9	0																
	(Evidenca nr. 16: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit).																					
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në dokumentacionin përkatës në DVV (Tabela 6.1; 6.2; 6.3), GVJ-ja konstaton se ngarkesa e personelit akademik efektiv përkon me kuadrin ligjor në fuqi (PAE duhet të realizojë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor) duke qenë se për tre vitet e fundit akademik e gjithë ngarkesa në program mbulohet nga PAE. <i>Gjithsesi, GVJ konstaton nga dokumentacioni në DVV dhe takimi me personelin akademik se ngarkesa mësimore për personelin akademik në institucion nuk është në përputhje me Udhëzimin nr.29 datë 10.09.2018 pika 6 ku parashikohet se ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale të shpërndara në dy semestra ose 3 lëndë vjetore ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale (Tabela 12.1.; 12.2; 12.3).</i>																					
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka nënshkruar kontrata punësimi me institucionin për një periudhë të konsiderueshme (ku përfshihen edhe mbulimet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore), të cilat ruhen në dosjet personale të tyre, për të cilat është përgjegjëse zyra e burimeve njerëzore. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësues të kësaj zyre, nga shqyrtimi i tri dosjeve rastësore të personelit të përfshirë në programin e studimit u konstatua, që në secilën dosje ndodhej i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që nga dita e aplikimit dhe deri në punësim. (DVV; Vizita në institucion – Takim me zyrën e burimeve njerëzore.)																					
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që	Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, GVJ-ja konstatoi se procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit për përzgjedhjen e personelit mbështeten në Statutin dhe Rregulloren e institucionit në përputhje me planin e tij strategjik. Në rekrutimin e personelit akademik një rol të veçantë luan fusha e tyre e specializimit, e																					

garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	cila ndikon pozitivisht në zhvillimin e departamentit dhe institucionit. GVJ-ja konstaton se procedura e rekrutimit të personelit akademik është si më poshtë: njoftimi për punësim të personelit akademik shpallet nga njësia kryesore dhe i dërgohet për aprovim drejtuesit të Fakultetit dhe për miratim rektorit. Pas miratimit Zyra e Burimeve Njerëzore bën shpalljen e vendit vakant në faqen e webit të institucionit bashkë me kushtet që duhet të përmbushin kandidatët dhe kriteret e vlerësimit. Pasi aplikantët dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm, dosjet vlerësohen nga dekani i fakultetit përkatës, përgjegjësi i njësisë bazë dhe një përfaqësues nga departamenti. Komisioni bën renditjen e kandidaturave të cilat i paraqiten rektorit për të zgjedhur fituesin. Vendimi i dërgohet Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Financës dhe për dijeni Fakultetit dhe Departamentit. Procedurën administrative të rekrutimit të personelit akademik e ndjek Sektori i Burimeve Njerëzore. (Evidenca nr. 68: Procedura e Rekrutimit të Stafit Akademik) (Evidenca nr. 68: Procedura e Rekrutimit të Stafit).
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në planin mësimor të programit, GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” nuk e ka të parashikuar në kurrikulën e tij zhvillimin e orëve laboratorike. Si rrjedhojë ky kriter nuk mund të gjejë zbatim. Mjediset dhe pajisjet në funksion të programit të studimit mirëmbahen nga stafi që ka kualifikimin e duhur si psh., ekspertët e IT-së.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit	GVJ-ja konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbajtjen e dosjeve të çdo anëtarit të personelit akademik dhe administrative, e cila përditësohet sipas kuadrit në fuqi. Çdo fillim semestri, me propozim të njësisë bazë, aprovim të dekanit dhe miratim të rektoratit personeli akademik rinovon ngarkesën në përputhje me udhëzimin për ngarkesën mësimore të stafit akademik pasi ka marrë miratimin e këshillit të departamentit. Këto konstatime u përforcuan gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore ku u pa se kjo zyrë dispononte të dhëna të plota mbi anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit. Gjatë shqyrtimit të tri dosjeve rastësore të personelit të




akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	përfshirë në programin e studimit u konstatua, që dosjet ishin të plota me dokumentacionin e duhur si: ID, CV, kontratë mes palëve, çertifikata të titujve dhe gradave shkencore, dëshmi të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, dëshmi gjuhësh të huaja etj. (Evidenca nr. 70: Udhëzim për Ngarkesën Mësimore; Evidenca nr. 49: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore). (Referuar vizitës në insitucion)
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, GVJ-ja konstaton se ky plan parashikon praktikën profesionale me 12 kredite. Për këtë arsye, në fillim të vitit akademik departamenti cakton një asistent pranë zyrës së planifikimit dhe karrierës, i cili së bashku me lektorin e lëndës së praktikës profesionale orientojnë dhe mbështesin studentët gjatë zhvillimit të praktikës. Ata mbikqyrin gjithë procesin që nga zgjedhja e institucionit, ku studenti dëshiron të kryejë praktikën e deri te dokumentacioni që vërteton realizimin e saj. Praktika profesionale është e detyrueshme për studentët që zgjedhin këtë program studimi. Përsa i takon realizimit të punimit të diplomës, studentëve u është vënë në dispozicion një manual me gjithë informacionin e nevojshëm për shkrimin e një punimi doktorature. Sipas RVB-së, komiteti shkencor në departament bën ndarjen e temave dhe të udhëheqësit të temës, pasi studentët kanë dërguar në departament propozimin e tyre mbi temën dhe udhëheqësin. (Evidenca nr. 74: Procedurë e Praktikës Profesionale; Evidenca nr. 37: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera; Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të	Bazuar në RVB, GVJ-ja konstaton se kryerja e praktikës profesionale jashtë ambienteve të KU “Bedër” mbikqyret nga zyra e Planifikimit të karrierës dhe pedagogu i lëndës së Praktikës, ku studenti ka detyrimin të dorëzojë formularët e plotësuar nga vetë studenti duke shpjeguar dhe ilustruar pjesëmarrjen aktive në praktikë. Përveç kësaj në përfundim të praktikës studenti duhet të dorëzojë formularët e praktikës të plotësuar nga lektori i lëndës dhe personeli pritës.

praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	(Evidenca Shtese nr. 1-Raste Praktike Profesionale MSC ELL. pdf)			
Konkluzione	<i>Personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit. GVJ-ja konstaton se për vitin akademik 2023-2024, stafi mësimdhënës në programin e studimit paraqitet të jetë personel akademik efektiv, pra konstatohet se PAE mbulon 100% të ngarkesës mësimore.</i> <i>Rekrutimi i personelit akademik dhe administrativ kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga institucioni, me kriteret të përgjithshme dhe specifike. Të gjitha të dhënat e stafit ruhen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ndjek dhe përditësimin e dekomuntacionit për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ sipas rregullores përkatëse. Për të ndihmuar studentët në realizimin me sukses të praktikës profesionale departamenti vë në dispozicion të tyre lektorin e lëndës dhe përfaqësuesin në zyrën e karriervs.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në vizitën e kryer në institucion dhe dokumentacionin shoqërues në DVV, GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në përputhje me specifikën e programit të studimit dhe në varësi të numrit të studentëve. Njësia kryesore dhe ajo bazë shfrytëzojnë 14 salla leksionesh dhe seminaresh, 1 sallë për aktivitete promovuese, 1 për praktikën profesionale, laboratorë informatikë 2 laboratorë, 1 sallë për internet dhe 1 për bibliotekën institucionale etj. (Tabela 16)

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se auditorët ishin të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike. Kështu, sallat ku zhvillohen leksionet, seminarët, biblioteka ishin të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për të siguruar mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore. Në të gjithë auditorët gjendeshin edhe tabela interaktive, projektorë kompjuter, internet etj. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me ndriçim të mjaftueshëm dhe kondicionim. (Tabela 16 dhe Shtojca 2).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga plan programi i programit të studimit kuptohet se laboratorët për punë eksperimentale nuk janë të nevojshëm. Gjithsesi, sikur është përmendur edhe më lart, auditorët janë të pajisur me aparatura dhe mjetet e nevojshme elektronike. Laboratorët e kompjuterave dhe teknologjisë, salla e multimedias etj janë të gjitha në shërbim të mirëfunksionimit dhe realizimit dhe përmbushjes së objektivave të programit të studimit.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ-ja konstaton se institucioni ka në funksion dy laboratorë informatike të teknologjisë së fundit dhe një sallë interneti, të cilat janë të dispozicion të programit të studimit (Evidenca – Shtojca nr.1)
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	GVJ-ja konstaton se plani mësimor i programit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” përmban praktikën profesionale si lëndë të detyrueshme. Kjo praktikë realizohet si brenda institucionit ashtu edhe në kompani dhe institucione të ndryshme. Ndonëse Tabela 5 tregon se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikës së programit me 4 institucione, nuk ka asnjë marrëveshje të nënshkruar me to. Pjesa më e madhe e studentëve zgjedhin ta kryejnë praktikën në institucion. (Evidenca nr 92: Rast Praktike Profesionale

	Zhvilluar pranë Institucionit; Evidenca nr. 77: Lista e Institucioneve me të cilat KU Bedër ka Marrëveshje Partneriteti për Bashkëpunime në Fusha të Ndryshme) <i>GVJ konstaton mungesën në dokumentacion të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes KU "Bedër" dhe institucioneve të tjera, ku studentët realizojnë praktikën.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni KU "Bedër" ofron në shërbim të realizimit dhe mirfunksionimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Gjuhë dhe Letërsi Angleze" mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Këto ambiente janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit dhe janë të gjitha me ndriçim të mjaftueshëm dhe ngrohje/ftohje. Institucioni vë në dispozicion të programit dy laboratorë kompjuterikë dhe një sallë interneti, bibliotekën dhe salla të mjaftueshme për të zhvilluar seminarët dhe leksionit. Kryesisht, praktika profesionale realizohet për këtë program pranë institucionit.</i> <i>GVJ-ja rekomandon rregullimin e gjithë procedurës së zhvillimit të praktikës profesionale edhe në institucione të tjera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në	Referuar vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, GVJ-ja konstaton se literatura bazë dhe ndihmëse për

dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	programin e studimit u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe elektronike përmes sistemit të brendshëm BIS. Ndonëse RVB-ja thekson se literatura bazë dhe ndihmëse përditësohen vazhdimisht, kjo gjë që nuk është konstatuar nga <i>GVJ-ja, e cila konstaton nga shqyrtimi i sillabuseve të lëndëve në këtë program se literatura në shumicën e tyre është e vjetëruar, gjë që nuk i ndihmon studentët të marrin dije dhe njohuri bashkëkohore. Literatura është në gjuhën anglisht, në përputhje me programin.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Në RVB theksohet se në fillim të çdo viti akademik, njësia përgjegjëse për programin e studimit kujdeset që lektorët të përditësojnë literaturën me botime të viteve të fundit, të cilat pasi miratohen i dërgohen rektoratit dhe bibliotekës për të plotësuar nevojat e tyre me literaturën e kërkuar. <i>GVJ-ja konstaton se jo e gjithë literatura e përdorur në program gjendet në formën hardcopy, ndaj rekomandon pasurimin e bibliotekës me literaturën detyrueshme apo të rekomanduar që lektorët përdorin në lëndët që mbulojnë.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar DVV-së dhe vizitës në institucion GVJ-ja konstaton se institucioni KU “Bedër” ka në dispozicion të çdo studenti të programit të studimit një bibliotekë fizike dhe u garanton atyre mundësinë e shfrytëzimit të saj në mënyrë të barabartë. Në bibliotekë gjenden titujt kryesorë që përfshihen në literaturën e çdo programi. Përveç kësaj, institucioni u ka krijuar mundësinë studentëve dhe stafit që përmes emailit institucional të mund të aksesojnë burime akademike nga JSTOR me të cilën institucioni ka marrëveshje. (Evidenca nr. 57: Udhëzim mbi Funkcionimin e Bibliotekës; Evidenca nr. 54: Marrëveshja për Akses në JSTOR; Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike dhe asaj online)
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo	GVJ-ja konstaton se institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve bibliotekën fizike gjatë gjithë ditëve të javës dhe gjatë sezonit të provimeve edhe në fundjave. Pavarësisht se biblioteka ofron një gamë të gjerë titujsh në shërbim të fushave të studimit që mbulon programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” GVJ-ja rithekson faktin e përmendur edhe më lart se

revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	është e nevojshme të vazhdojë pasurimi i fondit fizik të bibliotekës me literaturë të viteve të fundit për të gjitha lëndët / modulet dhe veprimtaritë mësimore të programit të studimit. Për t'u vlerësuar është mundësia e ofruar nga institucioni për përdorimin online të bibliotekës JSTOR ku studentët dhe personeli akademik, kanë mundësi të shfletojnë rreth 12 milionë artikuj të botuar në revista shkencore. (Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike; Evidenca nr. 57: Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës)
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka krijuar kushtet që të gjithë studentët të shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë bibliotekën online, për të siguruar literaturën e nevojshme për fushën e programit të studimit. Ky shërbim ofrohet pa pagesë jo vetëm për studentët, por edhe për personelin. (Evidenca nr. 57: Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi gjatë vizitës së saj në ambientet e bibliotekës së KU "Bedër" se kjo bibliotekë është e pajisur me aparatura kompjuterike dhe me programe kompjuterike, të cilat u mundësojnë studentëve realizimin e studimit, detyrave të kursit, projekteve etj duke u vënë në dispozicion materiale shkencore edhe të formës dixhitale sipas kërkesave të tyre. Gjithashtu, databaza bërthamë e Bibliotekës së KU "Bedër" gjendet online. (Evidenca nr. 57: Udhëzim mbi Funksionimin e Bibliotekës).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ-ja konstatoi gjatë vizitës në institucion se kapaciteti i bibliotekës i përgjigjet numrit të studentëve dhe nevojave të tyre për mjedise dhe pajisje. Orari i punës për bibliotekën (nga ora 8:30-19:00) përshtatet me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe është i afishuar para hyrjes së bibliotekës. Gjatë sezoneve të provimit biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë. Për tu përgëzuar është automatizimi i bibliotekës, i cili u mundëson studentëve regjistrimin në formë elektronike. <i>GVJ-ja konstaton mungesën e në udhëzuesi për studentin në lidhje me përdorimin e Bibliotekës Online, gjë që do tu vinte në ndihmë të gjithë studentëve e sidomos studentëve të vitit të parë.</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe	GVJ-ja konstaton se në fillim të çdo viti akademik Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze pas konsultimit me lektorët paraqet herë pas here kërkesa për pasurim të literaturës, blerje librash e

raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	materialesh (Evidenca nr.47). Institucioni parashikon vazhdimisht një fond për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, një pjesë e të cilit i dedikohet pasurimit të bibliotekës me botime dhe publikime të fundit në fushën e programit të studimit sipas literaturës së përcaktuar në programet lëndore. <i>Gjithsesi, nga biseda me stafin akademik dhe nga shqyrtimi i literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar, GVJ-ja konstaton se jo të gjitha kërkesat e personelit akademik për literaturë hardcopy arrijnë të plotësohen nga institucioni.</i> (Evidenca nr. 47: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze).			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se studentët kanë mundësi ta aksesojnë literaturën bazë dhe ndihmëse për programin e studimit si në formë fizike ashtu edhe elektronike. Institucioni u garanton studentëve mundësinë e barabartë të shfrytëzimit të bibliotekës duke u ofruar mjedise të përshtatshme për të punuar. Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe programe kompjuterike, gjë që u mundëson studentëve gjetjen e informacionit të nevojshëm në studimin e tyre. Oraret e bibliotekës janë përshtatur me kohën e zhvillimit të procesit mësimor duke qenë hapur gjatë gjithë javës dhe në kohë sezoni edhe në fundjavë.</i> <i>Duke konstatuar mungesë të librit fizik në fondin e bibliotekës, GVJ-ja rekomandon pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me kopje fizike të literaturës së viteve të fundit për të gjitha lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ-ja konstaton se institucioni disponon sistemin e brendshëm të automatizimit BIS, nëpërmjet të cilit arrin të ndjekë dhe bashkërendojë veprimtaritë e shumta institucionale. Ky sistem mundëson administrimin e të gjithë informacionit mbi studentët nga regjistrimi i tyre në programin e studimit e deri në ditën e diplomimit. Studentët, personeli akademik pajisen nga institucioni me një llogari në sistemin BIS, ku mund të aksesojnë çdo informacion të nevojshëm për veprimtarinë e tyre brenda institucionit. Syllabuset e lëndëve dhe të dhënat për secilin student gjenden aty duke filluar nga frekuentimi, shpallja e studentëve kalues ose jo, shpërndarja e krediteve sipas viteve etj. (Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ-ja evidenton bazuar në informacionin e nxjerrë nga shqyrtimi i DVV-së dhe konstatimeve gjatë vizitës në institucion, se sistemi i brendshëm BIS, që disponon institucioni mundëson ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarive institucionale në mënyrë të automatizuar. Njësitë që kanë akses në këtë sistem janë: studentët, stafi akademik, zyra e burimeve njerezore, zyra e sekretarisë mësimore, biblioteka, sekretaritë e departamentet, zyra e financës dhe çështjeve administrative, zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median dhe zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare. Përmes këtij sistemi arrihet të realizohet jo vetëm qarkullimi i informacionit, por edhe gjurmimi i aktivitetit të personelit akademik, ndihmës-akademik, administrative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit Evidenca nr. 53: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Pas shqyrtimit të informacionit në DVV dhe pas takimit me stafin akademik në program, GVJ-ja konstatoi se i gjithë personeli akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ si dhe të gjithë studentët e programit të studimit kanë akses në informacione e dokumentacion, të siguruara nga sistemi i menaxhimit. (DVV; Vizita në institucion: takim me stafin, takim në

	sekretarinë mësimore; Evidenca nr. 53: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga dokumentacioni në DVV dhe bisedat me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, GVJ-ja konstaton se përmes sistemit BIS institucioni ka realizuar qarkullimin dhe sinkronizimin e të dhënave në kohë reale si dhe transferimin e tyre nga njëra njësi në tjetrën. Përmes këtij sistemi personeli akademik dhe studentët komunikojnë dhe shkëmbejnë informacione të ndryshme mbi lëndët, syllabuset, detyrat e kursit, vlerësimin në provim etj. (DVV; Vizita në institucion: takim me stafin, takim me studentët)
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ-ja konstaton se përmes sistemit të automatizuar BIS, mundësohet monitorimi në kohë reale i veprimtarisë së personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve si dhe raportime individuale dhe të dhëna për organet drejtuese dhe titullarët. Ky sistem mundëson monitorimin e procesit mësimor, regjistrimin e studentëve në lëndët e semestrit përkatës, në rast se kanë mangësi të caktuara në dokumentacion që nuk u lejon regjistrimin, plotësimi i dokumentave të nevojshme, vlerësimi i studentëve, respektimi i orarit etj. (Evidenca nr. 53: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS).
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ-ja konstaton se faqja zyrtare e institucionit KU "Bedër" mban të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me njësinë akademike dhe administrative, mbi programin e studimit, burimet njerëzore, aktivitetet e ndryshme etj. Informacionet e publikuara në faqen zyrtare të internetit janë në gjuhën shqipe dhe atë angleze dhe studentët aty gjejnë informacion mbi kalendarin akademik, orarin e leksioneve dhe provimeve, njoftimi mbi praktikat profesionale, mundësi punësimi apo veprimtari të tjera të zhvilluara nga struktura të tjera që veprojnë pranë KU "Bedër". http://www.edueng.beder.edu.al/
Konkluzione	<i>KU "Bedër" disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit BIS, përmes të cilit administron të gjithë informacionin mbi personelin akademik, ndihmës akademik, administrative e partnerë të tjerë në ndihmë të programeve të studimit. Nëpërmjet këtij sistemi qarkullon dhe mbikqyret informacioni mbi studentët që nga</i>




	<i>momenti i regjistrimit në programin e studimit deri në diplomimin e tyre. Ky sistem administron edhe Informacionin dhe dokumentacionin e personelit akademik, duke pasqyruar planin mësimor, orarin, vlerësimet e provimeve, oraret e konsultimeve etj. I gjithë personeli akademik e administrativ dhe të gjithë studentët e programit të studimit kanë akses në informacione e dokumentacione të siguruar nga sistemi i menaxhimit.</i> <i>Në faqen zyrtare të institucionit gjendet në dy gjuhë shqip dhe anglisht informacioni mbi programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitetet e ndryshme institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Pas shqyrtimit të DVV-së dhe vizitës në institucion, u konstatua që Fondacioni “Hafiz Ali Korça” harton në mënyrë periodike një raport financiar, ku parashikohen të detajuara të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit. KU “Bedër” karakterizohet te lloji i institucionit të lartë arsimor jo-fimprurës, për këtë arsye të ardhurat kryesore për këtë institucion vijnë nga donacionet. Projekt buxheti i hartuar nga departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, vërteton se institucioni siguron të ardhura të mjaftueshme për të mbështetur mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike në programet e studimit për një cikël të plotë studimi, nga regjistrimi i studentëve në program e deri në diplomimin e tyre. (Evidenca nr. 47: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze)

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Referuar dokumentacionit përkatës (Evidenca nr. 47: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze), GVJ-ja konstaton se projekt buxheti i departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze pasqyron me detaje të ardhurat dhe shpenzimet e departamentit sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Në këtë projekt-buxhet përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e bëra nga departamenti qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë siç janë të ardhurat nga konferencat, projektet, seminarët apo shpenzimet për realizim workshop-i, konferenca, promovimi, aktivitete studentore, blerje literature, shpenzime të personelit etj. Të gjitha shpenzimet financiare të departamentit që ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” pasqyrohen edhe në raportet e zyrës së Financës. (Evidenca nr. 47: Projekt Buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze; Tabela 18)
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas RVB-së, KU “Bedër” i nënshtrohet auditit të brendshëm dhe të jashtëm. Audit i jashtëm realizohet nga një kontabilist i miratuar, i cili raporton mbi situatën financiare të fondacionit “Hafiz Ali Korça”. Ky raport ruhet pranë Fondacionit. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion për shqyrtim në DVV, GVJ-ja konstaton se institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij përmes auditimit të brendshëm të realizuar nga zyra përkatëse. (Evidenca nr. 81: Raporti i Auditimit të Brendshëm; Evidenca nr. 82: Procedura për Auditim Periodik të Brendshëm).

Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e marrë nëpërmjet RVB-së dhe DVV-së, GVJ-ja konstaton se pasi departamenti harton projekt buxhetin ia kalon atë fakultetit, i cili harton buxhetin e tij bazuar në kërkesat e njësisë bazë. Ky buxhet i kalohet institucionit për hartim si pjesë e buxhetit institucional. Në raportin vjetor institucional të KU “Bedër” përfshihet buxheti i vitit të kaluar dhe projekt buxheti i vitit të ardhshëm akademik si dhe projekt buxheti afatmesëm, të cilat i kalohen çdo fund viti Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	(Evidenca nr. 82: Procedura për Auditim Periodik të Brendshëm) Bazuar në shqyrtimin e raporteve financiare të vëna në dispozicion në DVV, rezulton se KU “Bedër” mban statusin e institutit të arsimit të lartë jo-fitimprurës. GVJ-ja konstaton se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe bashkë me mbështetjen e donatorëve zotëron kapacitetet e mjaftueshme financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe gjenerimin e të ardhurave për përmirësimin e situatës financiare. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU “Bedër” bëhet në bazë të një programi financiar, i cili hartohet në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, ligjin nr.87, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga zbatimi i tyre.
Konkluzione	<i>KU “Bedër” mban statusin e institucionit të lartë jo-fitimprurës. Në mënyrë periodike ai organizon një audit të brendshëm dhe të jashtëm financiar. Në fund të çdo viti akademik, institucioni paraqet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit një raport vjetor institucional ku përfshihen: buxhetori i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik dhe projektbuxheti afatmesëm. Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacite të mjaftueshme financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit. Të ardhurat kryesore sigurohen nga donacionet. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU “Bedër” në të cilin përfshihen: financimi i burimeve njerëzore, shërbime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzime për laboratorë, fonde për aktivitete shkencore etj.,</i>



	realizohen në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, ligjin nr.87, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga zbatimi i tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në RVB, statutin dhe rregulloren themelore të KU “Bedër”, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e Departamentit dhe të programit të studimit, GVJ-ja konstaton se pranimi i studentëve të ciklit të dytë në programin Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe mbi bazën e kriterëve të miratuara për pranimin e studentëve. Institucioni ka ngritur strukturat e nevojshme të cilat asistojnë studentët me informacion, orientim, këshillim dhe ankimim nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe regjistrimit në program e deri në momentin e përfundimit të studimeve dhe u krijojnë studentëve kushte të barabarta për të studiuar, për të qenë të përfaqësuar në organe të ndryshme, për t’u informuar, për tu vlerësuar, për të përdorur infrastrukturën në mbështetje të programit të studimit dhe për të qenë pjesë e mobiliteteve studentore etj. (Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar

	“Bedër”; Evidenca nr. 66: Kuotat dhe Kriteret e Pranimi të Studentëve; Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se KU “Bedër” u përmbahet politikave dhe procedurave që sigurojnë trajtimin e barabartë të kandidatëve për student që nga hyrja e deri në dalje. Këto procedura dhe politika mbështeten në Ligjin e Arsimit të Lartë, statuti dhe rregullorja e institucionit, rregullorja e programit të studimit si edhe udhëzimet e MAS. Kriteret e pranimi të studentëve të rinj publikohen në faqen e institucionit. Kalimi i studentëve nga njëri vit akademik te tjetri bëhen po ashtu publike në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e ciklit të dytë. Institucioni ndjek politika mbështetjeje si për studentët me aftësi të kufizuara ashtu dhe për studentët e talentuar që kanë fituar çmime duke ju ofruar tarifa studimi falas deri në masën 100%. (Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë; www.beder.edu.al)
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ-ja konstaton se procedurat e pranimi për programet “Master” dhe kuotat së bashku me kriteret për çdo program studimi dorëzohen në ministrinë e Arsimit dhe Sportit përpara çdo viti akademik. I gjithë ky informacion bëhet i aksesueshëm për publikun përmes faqes zyrtare të internetit dhe kanaleve të ndryshme promovuese. Një nga këto është dhe organizimi i panairit “Work and Study”. (Evidenca nr. 84: Pjesëmarrja në Panairin “Work and Study”)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit	GVJ-ja konstaton se në faqen zyrtare të KU “Bedër” gjenden të gjitha informacionet kryesore që lidhen me programet e studimit si për studentët ashtu dhe për palët e treta. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve gjenden të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe janë të aksesueshme nga publiku. Çdo njësi bazë ka faqen e vet të internetit, e cila mund të aksesohet ose drejtpërsëdrejti ose përmes faqës së fakultetit. Në bazë të inspektimit të faqes zyrtare të KU “Bedër” vihet re një transparencë mbi programet e studimit përfshi personelin akademik, kurrikulat, këshillat e departamenteve





janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	etj. (https://edueng.beder.edu.al/). Gjithashtu, procedurat e përzgjedhjes së studentëve dhe njoftime që lidhen me procesin e regjistrimit apo transferimet të studimeve gjenden në faqen zyrtare të institucionit dhe në platformën që administrohen nga KU “Bedër”. Këto informacione mund të merren edhe në sekretariatë e departamenteve, sekretaira mësimore dhe zyra e pranimit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Nga GJVJ-ja konstatohet se, në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, publiku dhe të interesuarit marrin informacione dhe udhëzime nga institucioni në dy mënyra: përmes faqes së tij zyrtare (https://edueng.beder.edu.al/) në dy gjuhë anglisht dhe shqip si dhe përmes fushatave promovuese, nëpërmjet aktiviteteve informuese me nxënës maturantë, panairove të ndryshme ku aplikantët mund të marrin pjesë dhe të vizitojnë ambientet e institucionit për të parë infrastrukturën (Evidenca nr. 83: “Open Day” pranë Ambienteve të KU “Bedër”)
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ-ja evidenton se përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kuotat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë. Këto kriteret janë të barabarta për të gjithë, përfshi këtu edhe për kandidatët me aftësi të veçanta, studentët që u përkasin grupeve dhe komuniteteve të marginalizuara. Për tu përgëzuar është fakti që institucioni ofron bursa studimi për shtresat në nevojë të cilat janë të pasqyruara në rregulloren përkatëse. Gjithashtu, institucioni ofron bursa ekselence dhe bursa për kategoritë e studentëve me status invalidi, tetraplegjiku, paraplegjiku etj. (Evidenca nr. 69: Rregullorja mbi Zbritjet e Tarifave të Studimeve).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ-ja konstaton se në fillim të çdo viti akademik KU “Bedër” bën publike kuotat dhe kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve për student që nuk janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë. Më konkretisht, në departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ka patur vazhdimisht studentë nga shtete të tjera. (Evidenca nr. 66: Kuotat dhe Kriteret e Pranimit të Studentëve)

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ-ja konstaton nga vizita në institucion dhe dokumentacioni në DVV, se në rregulloren themelore të institucionit dhe rregulloren e ciklit të dytë të studimit përcaktohet se bursat sociale janë të masës 100% për kategoritë e jetimit, pa kujdestari prindërore, pa mundësi ekonomike, fëmijëve të dëshmorëve, status invalidi etj. Institucioni u jep mundësi studentëve të kategorive të sipërpërmendura jo vetëm të studiojnë, por edhe të bëhen pjesë e trajnimeve, aktiviteteve etj. Konstatohet se për studentët nga shtresat në nevojë institucioni u mundëson të drejtën të studiojnë në degën e preferuar në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e tyre sipas tregut të punës. (Vizita në institucion, takim me studentët).			
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se KU "Bedër" harton dhe zbaton politika dhe procedura, që mbulojnë një cikël të plotë akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke iu referuar Ligjit Arsimit të Lartë, udhëzimeve të MAS si dhe VKM-ve përkatëse. Institucioni garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Përcaktimi i kuotave dhe kriterëve të pranimi të studentëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Informacionet dhe udhëzimet e nevojshme në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose mund të meren nga të interesuarit përmes fushatave promovuese, aktiviteteve informuese, organizimit të ditëve të hapura, panaiereve etj. Në shpërndarjen e kuotave për kandidatët për studentë janë të parashikuara edhe kuota për kandidatët nga trojet, për transferim studimesh, për kandidatë me statusin e jetimit, për persona me aftësi të kufizuar, kandidatë që nuk janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë apo të shtresave të marginalizuara. Për studentët nga shtresat në nevojë institucioni harton politika mbështetëse dhe ofron ndihmë financiare deri në masën 100%.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ-ja konstaton se përveç informimit nga faqja zyrtare e internetit në lidhje me informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentit, studentët mund ti drejtohen Guidës së Studentëve ose zyrës të sekretarisë mësimore, sekretarisë së departamentit dhe këshilltarit akademik, i cili ka njohurit të thella në lidhje me procesin e të mësuarit. (Evidenca nr. 30: Guida e Studentit; Evidenca nr. 64: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në DVV dhe bisedën me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se studentët marrin informacion për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve apo studimet e pjesshme nga Guida e Studentëve, sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit. Ata marrin informacion mbi programin e studimit, mbi mundësinë dhe njohjen e krediteve në rast transferimi të studimeve, ku diploma mund të merret vetëm në rast se studenti ka përfunduar dy semestra studimi në KU “Beder”. (Evidenca nr. 28: Rregullorja e Transferimit të Studimeve; Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ-ja konstaton përmes takimeve me studentët, drejtuesen e njësisë bazë dhe stafin akademik si dhe nga dokumentacioni në DVV, se studentët vihen në dijeni të lëndëve të programit në faqen zyrtare të institucionit dhe departamentit. Aty studentët gjejnë informacion mbi temat në syllabusin e çdo lënde, objektivat dhe kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Informimi i studentëve bëhet gjithashtu gjatë javës së parë të studimeve përmes sistemit BIS, ku studentët gjejnë informacion mbi leksionet, seminarët, notat, pikët dhe mesataren në fund të semestrit. (Vizita në institucion)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë	GVJ-ja eidenton se institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Këto procedura parashikohen në rregulloren e programit të studimit si dhe në

informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	rregulloren e ciklit të dytë të studimeve. Në dispozicion të studentëve institucioni ka vendosur dhe manualin për punimin e tezës së diplomës, i cili përmban gjithë udhëzimet e nevojshme mbi punimin e tezës së diplomës. Në RVB, thuhet se studenti kryen seanca konsultimi me udhëheqësin shkencor përgjatë semestrit të fundit por nuk ka evidencë mbështetëse. (Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”; Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë). (Evidenca nr. 72: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni angazhohet në marrëdhënie bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitat si dhe nxit pjesëmarrjen në aktivitete dhe panairë arsimore, që zhvillohen në qytete të ndryshme. Informimi i të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, tarifat e shkollimit dhe bursat e mundshme bëhen publike përmes faqes zyrtare të KU “Bedër”, platformave e mediave sociale, broshurave, aktiviteteve informuese si “Open Day”. (Evidenca nr. 84: Pjesëmarrja në Panairin “Work and Study”). (Evidenca nr. 83: “Open Day” pranë Ambienteve të KU “Bedër”)			
Konkluzione	<i>KU “Bedër” përdor platforma të ndryshe informimi në lidhje me programet e studimit që ofron, për kandidatët për student dhe palët e treta të interesuara, si faqja zyrtare e institucionit, fakulteteve dhe, departamenteve, si dhe informacionit të drejtpërdrejtë nga sekretaria mësimore dhe pedagogët e lëndëve apo aktivitete informuese si Open Day apo panairët dhe workshope-ve. Studentëve u vihet në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, mbi procedurat e njohjeve të kualifikimeve, mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive të tyre, mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e plotë, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit që në javën e parë të vitit akademik. Gjatë kësaj jave ata njihen me stafin akademik dhe këshilltarin akademik të tyre, i cili i mbështet përgjatë gjithë kohës së studimeve. Ky i fundit i informon në lidhje me procesin mësimor dhe çdo çështje tjetër që lidhet me ecurinë e studimeve të tyre. (Evidenca nr. 67: Programi i Ditëve të Orientimit; Evidenca nr. 36: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë; Evidenca nr. 64: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ-ja konstaton se studentëve u vihet në dispozicion i gjithë informacioni mbi lëndët që zhvillohen gjatë programit të studimit si edhe mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nga pedagogu përkatës. Këto informacione si dhe informacione shtesë mbi pedagogët që japin mësim në program, kurrikulën, laboratorët kompjuterik dhe infrastrukturën në shërbim të programit studenti i merr si nga pedagogët e lëndëve, ashtu edhe nga faqja web e institucionit apo sistemi BIS. Sekretaria e departamentit është gjithashtu në shërbim të studentit. (Faqja web www.edueng.edu.al ; Vizita në institucion –takim me stafin akademik, takim me studentët; Evidenca nr. 30: Guida e Studentit).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ-ja konstaton se institucioni ka ngritur strukturat e duhura për informimin dhe orientimin e studentëve në lidhje me mundësitë që ofron tregu i punës. Konstatohet se zyra e planifikimit të karrierës pranë dekanatit të studentëve mbulon orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Kjo zyrë ka përfaqësues nga çdo departament, ku një prej anëtarëve të tij mer rolin e këshilltarit të karrierës. Në bashkëpunim me zyrën, këshilltari i karrierës organizon takime me studentët, i trajnon, i udhëzon dhe i informon në lidhje me praktikatat profesionale, pjesëmarrjen dhe aplikimin në pozicione intershipi ose pune të ofruara nga zyra e karrierës dhe institucione të ndryshme në

	tregun e punës. (Evidenca nr. 37: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera; Evidenca nr. 60: Raport i Zyrës së Planifikimit të Karrierës)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Takimi informues me stafin akademik dhe studentët tregon se informimi i këtyre të fundit në lidhje me njësinë bazë, lektorët, programin e studimit, kurrikulën, labororet kompjuterikë, infrastrukturën, sistemin e automatizuar BIS si dhe shërbimet e ofruara nga zyrat e tjera bëhet që në javën e parë të fillimit të studimeve. Në faqjen zyrtare web të KU “Bedër”, studentët gjejnë orarin mësimor. Email-et përdoren gjithashtu si mjet informimi nga sekretaritë, zyrat administrative në lidhje me aktivitetet, trajnimet dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme. (Vizita në Institucion)			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni mbi programin e studimit që u ofrohet studentëve nga sistemi i menaxhimit të informacionit BIS, është lehtësisht i arritshëm prej tyre, madje edhe në distancë përmes email-eve, me të cilat institucioni i pajis që në momentin që nënshkruajnë kontratën e studimit. Sistemi mundëson komunikimin e studentëve me stafin akademik si dhe në marrjen e çdo informacioni tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor. (Evidenca nr. 30: Guida e Studentit)			
Konkluzione	KU “Bedër” ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për të mundësuar informimin e studentëve mbi procedurat e vlerësimit dhe përparimit të tyre, njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme, këtu përfshihen: faqja zyrtare e KU “Bedër”; takimet me stafin akademik; sekretaria mësimore e fakultetit; këshilltarët akademik pranë zyrës së karrierës, të cilët i informojnë studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, mbi mundësitë e punësimit, mbi organizimin e procesit mësimor, praktikën profesionale dhe mbi shërbimet në funksion të realizimit të tij. Institucioni i orienton ata drejt tregut të punës nëpërmjet zyrës së komunikimit dhe karrierës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ-ja konstaton nga dokumentacioni në DVV dhe vizita në institucion se Zyra e Sekretarisë Mësimore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të plotë me të dhënat personale për çdo student të regjistruar. Në përfundim të çdo semestri, kjo zyrë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ndërsa zyra e të diplomuarve disponon databasën me të dhënat e kontaktit për studentët e diplomuar, të cilat përdoren në rastet e organizimit të aktiviteteve ku kërkohet pjesëmarrja e tyre. (Evidenca nr. 20: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore; Evidenca nr. 59: Raport i Zyrës së të Diplomuarve; Vizita në sekretarinë mësimore)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ-ja konstatoi se zyra e sekretarisë mësimore në KU “Bedër”, disponon dosjet individuale të studentëve që përmbajnë informacion të detajuar që nga regjistrimi i tyre në program e deri në përfundim të tij apo tërheqjen nga programi. GVJ-së iu vendosën në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, student të larguar dhe student me status aktiv. Gjatë tre viteve të fundit akademike 2021-2024 në program janë regjistruar 25 studentë nga të cilët për periudhën 2020-20203 janë diplomuar vetëm 17 studentë, ndërkohë që nuk ka asnjë student të transferuar Numri i studentëve për tre vite akademike vijon si më poshtë: V.a 2021-2022: 9 studentë të regjistruar V.a 2022-2023: 8 studentë të regjistruar V.a 2023-2024 8 studentë të regjistruar Totali 25 studentë në tre vite akademike. (Tabela 21). (Evidenca nr. 20: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore; Vizita në sekretarinë mësimore; Evidenca Shtesë nr. 7-Tabelat e Rishikuara.pdf).
Kriteri 3. Të dhënat	Referuar DVV-së dhe vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se të

statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në formë elektronike përmes sistemit të brendshëm të informacionit BIS, por gjenden edhe në formën fizike pranë zyrës së sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se njësia përgjegjëse për analizimin e të dhënave nga dosjet individuale të studentëve që gjenden në sekretarinë mësimore gjeneron informacion nga këto dosje, i cili mund të përdoret si nga këshilltari akademik ashtu edhe njësia bazë. Këto të dhëna janë të sigurt dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar, në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave vetjake. (Evidenca nr. 51: Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik; Evidenca nr. 53: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)).
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në DVV, institucioni i nënshtrohet kontrollit periodik përmes njësisë së Auditit të Brendshëm, e cila ushtron veprimtarinë e saj për të vlerësuar zbatimin dhe respektimin e procedurave të menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të të gjitha njësive. Institucioni vlerëson dhe dokumenton saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë përkatëse. (Evidenca nr. 81: Raporti i Auditimit të Brendshëm; Evidenca nr. 82: Procedura për Auditim Periodik të Brendshëm)
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjuesve.	GVJ-ja konstaton se njësia bazë në mënyrë periodike harton në përfundim të vitit akademik një raport vjetor ku pasqyrohet ecuria e procesit mësimor, cilësia e studentëve gjatë vitit akademik, diplomimi i tyre e deri te numri i studentëve të punësuar. Të dhëna nga ky raport përfshihen në raportin Vjetor Institucional, i cili më pas dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Raporti përfshin dhe analizën SWOT me qëllim identifikimin dhe përmirësimin e kërkesave të njësisë bazë. (Evidenca nr. 35: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2022-2023)
Konkluzione	<i>Institucioni disponon dhe menaxhon përmes sistemit BIS dhe dosjeve fizike, që gjenden në sekretarinë mësimore statistika për</i>



	numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, për numrin e studentëve të diplomuar, për numrin e studentëve të tërhequr nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. Këto të dhëna janë të sigurta e konfidenciale, por edhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Raporti vjetor i njësisë pasqyron cilësinë në hyrje dhe në vazhdimësi të studimeve për të gjithë studentët në program, e cila bëhet pjesë e analizës për të marrë masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Gjithashtu, njësia bazë realizon dhe analizën SWOT, në bazë të së cilës evidentohen kërkesat dhe nevojat e saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ-ja konstaton se në përputhje me ligjin nr 80/2015 të arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren Themelore të KU “Bedër” studentët kanë përfaqësuesit e tyre të përfshirë dhe të angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese përfshi këtu Senatin Akademik, NJSBC-në, Komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë dhe këshillin e fakultetit dhe departamentit (fakt i mbështetur edhe nga vetë studentët gjatë bisedës me ta në ditët e vizitës në institucion). Një organ i rëndësishëm që garanton vazhdimësinë e anagazhimit të studentëve është dhe Dekanati i Studentëve, e cila në bashkëpunim me zyrat përbërëse ndihmon në ruajtjen e të drejtave të studentëve. Dekanati i studentëve është përgjegjës për të ruajtur kontaktet me studentët që nga momenti i tyre i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve si dhe pas punësimit. Me anë të këshillimit, kjo zyrë realizon aktivitetet sociale, mundëson praktikatat profesionale, angazhimin e studentëve në klube të ndryshme, ku studentët përfshihen jo vetëm në nisma sociale, por zhvillojnë edhe pasionet apo talentet e tyre si dhe i orientojnë studentët ndaj tregut të punës. Një tjetër organ që mbron të drejtat e përfaqësuesve të studentëve është dhe Këshilli Studentor, ku bëjnë pjesë përfaqësues nga çdo vit studimi.




	(Ligji i Arsimit të Lartë nr.80 dt.22.07.2015; Evidenca nr. 48: Vendimi i Senatit për Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit dhe në Këshillat e Fakulteteve; Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 3: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Beder”). (Evidenca nr. 86: Lista e Klubeve Studentore; Evidenca nr. 31: Vendim i Senatit për Miratimin e Ngritjes së KP; Vizita në institucion – bisedë me studentët e programit të studimit.)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në Statutin e KU “Bedër” (neni 98) dhe Rregulloren Themelore të tij, saksionohet prania e studentëve në mbledhjet e këshillave të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Institucioni ka garantuar përfshirjen e studentëve edhe në proceset e akreditimit. Mendimet e studentëve përfshihen edhe në procesin e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies duke i bërë pjesë të anketimit dhe vlerësimit të institucionit dhe stafit akademik. (Evidenca nr. 46: Listë Prezencë e Këshillit të Departamentit me Pjesëmarrjen e Studentëve; Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Beder”; Evidenca nr. 24: Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve; Evidenca nr. 88: Anketë Vlerësimi e Studenteve për Institucionin; Evidenca nr. 89: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” ka në fokus të tij përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, riorganizimit dhe përmirësimit të programit të studimit duke u mundësuar pjesëmarrjen aktive në takimet dhe mbledhjet e departamentit. Gjithashtu, institucioni i ka kushtuar një rëndësi të veçantë realizimit të proceseve vetvlerësuese si në aspektin akademik ashtu dhe atë administrative, ku njësia kryesore dhe njësia bazë përgatitin raportin vjetor ku një rëndësi të veçantë i kushtohet analizës SWOT dhe pjesëmarrjes së studentëve. Gjatë takimit me studentët në ditët e vizitës në institucion, u konstatua marrja e masave konkrete dhe të prekshme nga ana e institucionit, pas sugjerimeve të bëra nga studentët të cilët pranuan, se kanë ndjerë përmirësime të dukshme të procesit akademik apo në infrastrukturë pas dhënies së mendimeve të tyre. (Evidenca nr. 35: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2022-2023; Evidenca nr. 89: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga




	Studentët).			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ-ja vë në pah se institucioni u mundëson studentëve dhënien e mendimit të tyre mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit, si edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit dhe rishikimit apo reflektimit të tij nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Kjo e drejtë parashikohet për të gjithë studentët pa përjashtim në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë. Në takimin e zhvilluar me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët pohuan faktin që në çdo rast se ata kanë ankesa në lidhje me vlerësimin kanë mundësinë e rishikimit të rezultatit duke paraqitur ankesën në Sekretarinë Mësimore e cila më pas i kalohet njësisë bazë për hapa të mëtejshëm. (Vizita në institucion – Takimi me studentët; (Evidenca nr. 14: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).)			
Konkluzione	Në përputhje me ligjin nr 80/2015 të arsimit të lartë dhe bazës ligjore mbi të cilën funksionon institucioni KU “Bedër”, studentëve u garantohet e drejta për tu përfshirë dhe për tu angazhuar përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, si edhe në vlerësimin e procesit akademik. Ky i fundit realizohet përmes pyetësorëve, por edhe nga pjesëmarrja e studentëve në takimet dhe mbledhjet e departmentit ku merren vendime të rëndësishme në lidhje me vazhdueshmërinë dhe cilësinë e programit të studimit. Gjithashtu, studentëve u jepet mundësia e ankimimit të vlerësimit të dijeve nga ana e pedagogut të lëndës dhe në rast mosrënien dakort me këtë vlerësim, ata shprehin kërkesën në Sekretarinë Mësimore për rishikim dhe rishqyrtim të dijeve të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të	GVJ-ja konfirmon se institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve dhe palëve të treta të interesuara në lidhje me programin e studimit siç janë: zyra e

informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	sekretarisë Mësimore, zyra e Regjistrimeve, zyra e Planifikimit të Karrierës dhe zyra e të diplomuarve, e cila varet nga Dekanati i Studentëve, sekretaritë mësimore të njësisë bazë si dhe këshilltarët akademikë. Faqja zyrtare web e institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë ofron gjithashtu, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit. Sistemi BIS është po ashtu një formë e vlefshme informimi në të cilën studenti ndjek të gjithë ecurinë e performancës së tij në lëndët e semestrit dhe rezultatet përkatëse. Studentët njihen me syllabuset e secilës lëndë që në javën e parë të vitit akademik dhe në vazhdim komunikimi bëhet me email. (Evidenca nr. 30: Guida e Studentit; Evidenca nr. 53: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Për tu ardhur në ndihmë studentëve me informim, orientim dhe këshillim, institucioni ka udhëzuar krijimin e pozicionit të këshilltarit akademik dhe këshilltarit të karrierës, të cilët u ofrojnë studentëve ndihmë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe punësimin. Më konkretisht, këshilltari akademik informon studentët mbi vazhdimësinë e procesit mësimor, ndërsa këshilltari i karrierës në bashkëpunim me zyrën e Planifikimit të Karrierës ofron informacion mbi trajnime, seminare, leksione të hapura dhe mundësi punisimi apo aplikime për praktikën profesionale. (Evidenca nr. 37: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera; Evidenca nr. 64: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik).
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	Programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” si dhe programe të tjera e kanë të detyrueshme lëndën Praktikë Profesionale. Për tu ardhur në ndihmë studentëve me informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj praktike pranë institucioneve të tjera, KU “Bedër” ka bërë funksionale Zyrën e Planifikimit të Karrierës, e cila i mirëpret, këshillon dhe orienton studentët në procese të ndryshme të realizimit të praktikës profesionale, por edhe në këshillim kariere në lidhje me qasjen e tyre në tregun e punës. Njësitë bazë emërojnë këshilltarin e tyre pranë kësaj zyre, i cili informon studentët mbi trajnimet, seminarët dhe aktivitetet me karakter profesional që zhvillohen nga dhe jashtë institucionit.

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	(Evidenca nr. 37: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera)			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e të Diplomuarve si pjesë e Dekanatit të Studentëve krijon një databazë të dhënash mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Kjo zyrë harton raporte vjetore mbi realizimin e praktikave profesionale, partneritetet që KU “Beder” ka me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe shkallën e punësimit dhe cilësinë e studentëve në përfundim të studimeve të tyre. Ky fakt konstatohet nga GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion për vlerësim, ku për periudhën tre vjeçare 2020-2023 nga 17 të diplomuar nga ky program janë punësuar 12 studentë. (Evidenca nr. 59: Raport i Zyrës së të Diplomuarve; Evidenca shtesë nr.4- Të dhëna për tre vitet në tregun e punës për programin MSc ELL.)			
Konkluzione	KU “Bedër” në zbatim të ligjit nr.80/2015 të arsimit të lartë dhe Stututit të brendshëm të tij, ka vendosur në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, të këshillimit dhe orientimit të tyre zyrën e Sekretarisë Mësimore, zyrën e Regjistrimeve, zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe zyrën e të Diplomuarve. Këshilltari akademik dhe këshilltari i karrierës u ofrojnë studentëve ndihmë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe punësimin. Institucioni dhe njësia bazë, ofrojnë për studentët dhe palët e treta të interesuara për programin e studimit të gjithë informacionin e nevojshëm përmes sistemit të brendshëm BIS dhe faqes zyrtare web të institucionit, fakultetit dhe departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze. Zyra e Këshillimit të Karrierës krijon një databazë të dhënash mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës V	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ-ja konstaton nga informacioni në RVB dhe dokumentacioni bashkëlidhur në DVV, se Kolegji Universitar “Bedër” ka hartuar udhëzues të veçantë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave innovative të mësimdhënies. Gjithashtu, institucioni ka vendosur në dispozicion të programit të studimit për realizimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, infrastrukturën në shërbim të programit të studimit, mjetet vizuale si video-projektorë, laptop-e, bibliotekën on-line etj. Nga takimi me stafin akademik, GVJ-ja konstatoi se fokusi i tyre gjatë orëve të mësimdhënies është studenti dhe se roli i lektorit shihet si ndërmjetës mes studentit dhe kulturës angleze. <i>GVJ-ja sugjeron se rritja e numrit të lektorëve të departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, të cilët do të përfshiheshin në programet e mobilitetit do t'i shërbente këtij qëllimi pasi do rritej mundësia për të ndarë mes tyre përvojën e fituar nga vizitat në universitetet e vendeve të BE-së apo dhe më gjerë.</i> (Evidenca nr. 91: Udhëzuesi për Mësimdhënien Inovative)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Për të garantuar cilësinë e brendshme dhe aftësinë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik institucioni, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ndër të tjera udhëzon plotësimin e anketimeve nga ana e studentëve në fund të çdo semestri, ku bëhet vlerësimi i stafit akademik dhe lëndës. Sipas RVB-së performanca e personelit akademik vlerësohet gjithashtu nga plotësimi i formularit të vetvlerësimit, formularit të vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe vlerësimit që përgjegjësit të departamentit bën për personelin akademik në program.

	(Evidenca nr. 51: Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik; Evidenca nr. 55: Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies; Evidenca nr. 68: Procedura e Rekrutimit të Stafit Akademik)
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet anketës semestrale për pedagogun dhe lëndën. Në këtë anketë studenti vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, përmes rubrikave të vlerësimit të metodave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve, përgatitjen e pedagogut etj. Përmes rregullores së studimeve në ciklin e dytë studentëve u është garantuar e drejta për të ankimuar notën në rastet kur nuk bien dakord me vlerësimin. (Evidenca nr. 89: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët; Evidenca nr. 5: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”)
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga RVB-ja, konstatohet se rezultatet e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës të plotësuar nga studenti i vihen në dispozicion përgjegjësve të departamentit nga rektorati. Nga ana tjetër, njësia bazë u bën të ditur dekanatit dhe rektoratit vlerësimet që dalin nga formularët e vetëvlerësimit të pedagogut. Sipas RVB-së këto rezultate bëhen publike në faqen e njësive bazë (https://qac.beder.edu.al/surveys) <i>GVJ-ja konstaton se kjo faqe nuk është aktive, çka dëmton transparencën e institucionit me publikun.</i> (Evidenca-44-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar RVB-së, institucioni promovon të gjitha praktikat e nevojshme për të motivuar personelin akademik të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Për këtë qëllim KU “Bedër” përdor anketimin e studentëve për lëndën dhe pedagogun, rezultatet nga formulari periodik i vetvlerësimit dhe të dhënat nga raporti vjetor i njësive bazë. Këto rezultate përdoren si shtysë pozitive për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie por edhe në kërkimin shkencor. Nga vizita në institucion, GVJ-ja u informua se nuk ka patur raste të pedagogëve me rezultate të ulëta vlerësimi nga studentët. (Evidenca-17-Rregullorja për Funksonimin dhe Organizimin e

	Sistemit te Brendshem te Sigurimit te Cilesise. Neni 6; takimi në institucion). (Evidenca nr. 52: Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit; Evidenca nr. 97: Procedura e Vlerësimit të Performancës së Stafit Akademik).			
Konkluzione	KU "Bedër" nxit dhe ka miratuar udhëzues për përdorimin e metodave innovative në mësimdhënie. Për të realizuar vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie institucioni përdor si instrumenta: anketimin e studentit për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut; formularin e vetvlerësimit dhe formularin e vlerësimit të vazhdueshëm. Rezultatet i vihen në dispozicion rekrutit dhe njësisë bazë. Mbi bazën e këtyre të dhënave njësi bazë harton raportin vjetor ku evidentohet dhe nevoja për trajnime të stafit në drejtim të mësimdhënies dhe përdorimit të metodave inovatore nëse është e nevojshme. GVJ-ja konstaton se rezultatet e dala nga pyetësorët e studentëve, të cilët janë një tregues shumë i rëndësishëm i cilësisë së mësimdhënies në program duhet të analizohen dhe të bëhen pjesë e raporteve vjetore në nivel institucional, nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Gjithashtu, rezultatet nga këta pyetësorë duhet të bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit si pjesë e transparencës ndaj studentëve dhe publikut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore	Nga shqyrtimi i DVV-së dhe takimi me përfaqësues të NJSBC-së, GVJ-ja konstaton se siguri i brendshëm i cilësisë realizohet mbi bazën e politika dhe struktura të posaçme që institucioni ka ngritur në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. GVJ-ja konstatoi se strukturat përgjegjëse për mbikëqyerjen, vlerësimin, miratimin dhe garantimin evstandardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit në KU "Bedër" janë: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë


institucionale.	Institucionale dhe Programeve të Studimit; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin; zyra e Zhvillimit të Kurrikulës. Këto njësi funksionojnë në bazë të Statutit të KU “Bedër” (neni 28) dhe rregulloreve të tyre përkatëse. (Evidenca nr. 18: Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e KP për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit; Evidenca nr. 2: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 19: Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e NJSBC-së; Evidenca nr. 21: Rregullorja mbi Projektet Kërkimore Shkencore)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin në DVV dhe në vizitën e realizuar me përfaqësues të NJSBC-së në institucion, GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” ka ngritur ” ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit; Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Komisionin e Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin dhe zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës si struktura mbikëqyrëse dhe garantuese të standardeve të cilësisë në përgatitjen e studentëve sipas standardeve të. Përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Në përbërje të NJSBC-së janë pesë anëtarë nga të cilët tre janë staf akademik efektiv, një student dhe një ekspert i jashtëm. Funksionimi i kësaj njësie bazohet në rregulloren përkatëse. Gjithashtu, institucioni ka hartuar Politika të Sigurimit të Cilësisë dhe Politika e Përmirësimit të Programeve të Studimit, ku parashikohet përfshirja e studentëve dhe bashkëpunimi i tyre në sigurimin e cilësisë. (Tabela 24; Evidenca nr. 98: Politika e Kolegjit Universitar “Bedër” për Cilësinë; Evidenca nr. 99: Politika për Përmirësimin e Cilësisë së Programeve të Studimit në KU “Bedër”).
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve	Për të vlerësuar dhe garantuar cilësinë e vazhdueshme të programeve të studimit KU “Bedër” i nënshtrohet një vlerësimi të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Më konkretisht, institucioni i është nënshtrohet me sukses 3 akreditimeve institucionale: në vitin 2013 nga APAAL; në vitin 2017 nga Agjensia Britanike e Akreditimit “Quality Assurance Agency” dhe një tjetër proces




të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	vlerësimi dhe akreditimi institucional është realizua në vitin 2021 nga ASCAL. Sipas RVB-së, të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm së bashku me vlerësimit e dala nga ky proces, gjenden në faqen e institucionit. Ndërsa, programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është në proces riakreditimi. (Evidenca nr. 24: Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve)			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ-ja konstaton nga dokumentacioni në DVV, takimet me GVB-në dhe përfaqësuesit e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së KU “Bedër” përdor tregues të qartë dhe të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Bazuar në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve institucioni realizon në fund të çdo semestri një pyetësor me studentët në lidhje me lëndën dhe pedagogun e lëndës. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik personeli akademik bën plotësimin e formularit të vetvlerësimit mbi ecurinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe nga eprorët e tij plotësohet formulari i vlerësimit të vazhdueshëm. Të dhënat e nxjerra nga këta formularë ku evidentohen arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor por dhe problematikat, diskutohen në nivel njësie bazë dhe nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe gjejnë mënyrat e zgjidhjes së tyre.			
Konkluzione	<i>Për të garantuar vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë KU “Bedër” ka ngritur struktura në nivel institucional. Një nga këto struktura është dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në përbërje të kësaj njësie ka përfaqësues nga studentët dhe ekspertë të jashtëm. Qëllimi i kësaj njësie është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në institucion. Kjo njësi funksionon në bazë të rregullores së brendshme institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	KU “Bedër” përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit mbështetur në akte ligjore dhe nënligjore si dhe në politikat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programeve të studimit nëpërmjet pyetësorëve të studentëve që kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Rezultatet nga këto pyetësorë përpunohen në mënyrë statistikore i dërgohen nga rektorati njësive kryesore dhe njësive bazë për të shërbyer si bazë të dhënash për të realizuar propozime për ndryshime në programet mësimore apo ndryshime të kurrikulave të cilat realizohen në koordinim me zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave sipas procedurave përkatëse. Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore i përcillen njësive kryesore nga njësia bazë dhe shkojnë për miratim në Senat. Sipas RVB-së rezultatet e dala nga vlerësimi i jashtëm dokumentohen pas evidentimit të mangësive hartohen plane masash për përmirësimin e tyre. (Evidenca nr. 100: Planveprimi për Plotësimin e Rekomandimeve të BA për programin).
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ-ja konstaton se bazuar në raportet e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm, institucioni harton planveprime ku parashikohen marja e masave për të adresuar mangësitë e evidentuara në drejtim të cilësisë si dhe rezultatet e pritshme. Ky plan veprimi parashikon njësitet përgjegjëse që u ngarkohet detyra e ndjekjes së realizimit të masave të sugjeruara si dhe koha e realizimit të tyre. Rezultatet e vlerësimit nga studentët, stafi akademik dhe stafi administrativ publikohen në faqen zyrtare të institucionit ku gjithashtu gjendet dhe plani strategjik për vitin 2024-2028. (faqja web i KU Beder)
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të	<i>GVJ-ja konstaton se ky kriter është keqkuptuar nga GVB-ja e cila ka zhvendosur fokusin nga format e vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit, te format e vlerësimit të dijeve të studentit nga ana e lektorit.</i>

drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Gjithsesi, nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, GVJ-ja arrin të kuptojë se cilësia e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” monitorohet dhe kontrollohet nga drejtuesja e njësies bazë. Ajo mbikqyr cilësinë e mësimdhënies, disiplinën në punë dhe realizon analizat periodike të ecures së programit. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga njësia bazë, realizohet duke përdorur raportet e hartuara me të dhënat e dala nga formulari i vetvlerësimit të vazhdueshëm, pyetësi i studentëve dhe formulari i vetvlerësimit të stafit akademik.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ-ja konstaton nga RVB-ja, se KU “Bedër” përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Në fund të çdo semestri studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe lëndën përmes <i>Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës</i>, e cila ka për qëllim të tërheqë opinionin e studentëve në lidhje me aspektet e ndryshme të programit të studimit si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënies, mënyra e vlerësimit, njohja me sillabusin etj., si dhe të mundësojë mbi bazën e këtij informacioni përmirësimin e tij. <i>GVJ-ja konstaton se edhe pas vizitës në institucion nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion, ku të jenë të pasqyruara rezultatet e anketimit të studentëve mbi lëndën dhe pedagogun, përfundimet e dala mbi bazën e këtyre rezultateve apo masat konkrete të mara nga njësia kryesore.</i> Gjithashtu, studentët dhe personeli akademik shprehin mendimet dhe rekomandimet e tyre mbi shërbimet e ofruara nga institucioni përmes <i>Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit dhe Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit, të cilave për periudhën 2021-2023 gjenden të publikuara në faqen https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports. Dy instrumenta të tjerë për të përmirësuar cilësinë e programit të studimit dhe shërbimeve të ofruara për studentin janë dhe <i>Anketë vlerësimi për programin e studimit dhe Anketë vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit</i>.</i>




	<i>GVJ-ja rekomandon se realizimi i këtyre pyetësorëve është i domosdoshëm për të monitoruar dhe siguruar cilësinë në institucion dhe program. Gjithashtu, GVJ-ja sugjeron që pyetësorët e studentit mbi lëndën dhe pedagogun duhet të administrohen nga NJSBC-ja dhe jo njësia bazë. Përveç kësaj, GVJ-ja rekomandon jo vetëm realizimin e tyre, por edhe bërjen publike të rezultateve si një detyrim ndaj transparencës që institucioni ka kundrejt studentëve dhe palëve të treta.</i> (Evidenca nr. 62: Anketa Vlerësuese e Stafit Akademik ndaj Institucionit; Evidenca nr. 88: Anketë Vlerësimi e Studenteve për Institucionin; Evidenca nr. 89: Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët; Evidenca nr. 101: Anketë Vlerësimi e Studentëve për Programin e Studimit; Evidenca nr. 102: Anketë Vlerësimi e të Diplomuarve për Programin e Studimit)			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se KU "Bedër" bazuar në kuadrin e tij ligjor ka ngritur njësitë e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë periodike programet e studimit si dhe për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Ky vlerësim konsiston në përdorimin e metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit ndër të cilat janë dhe pyetësorët e studentëve për lëndën dhe lektorin. Përgjegjësi i njësisë bazë është përgjegjës për mbikqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së mësimdhënies në programin e ciklit të dytë.</i> <i>Megjithatë, në mungesë të dokumentacionit të bashkangjitur në DVV dhe pas vizitës në institucion GVJ-ja konstaton se nuk është e qartë se çfarë ndodh me rezultatet e dala nga pyetësorët e studentit për lëndën dhe pedagogun pas realizimit të tyre. Nga sa thuhet në raport dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion këta pyetësorë hartohen nga NJSBC-ja, por administrohen nga njësia bazë, gjë që zhvlerëson rolin e NJSBC-së në kontrollin e cilësisë së programeve. Po kështu, GVJ-ja konstaton mungesën e transparencës me studentët dhe publikun në lidhje me këtë aspekt të funksionimit të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Mbështetur në DVV dhe vizita në institucion GVJ-ja konstaton se KU “Bedër” ka parashikuar në Statutin e tij përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Senati Akademik në përbërje të të cilit janë rektori, dekanët dhe përfaqësuesit e asamblesë së fakulteteve, është organi kolegjial më i lartë që vlerëson dhe garanton cilësinë e programeve të studimit. Senati ngre Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, si dhe miraton zgjedhjen e anëtarëve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Të dy këto struktura kanë në përbërje të tyre përveç stafit akademik edhe përfaqësues të studentëve dhe aktorëve të jashtëm. Studentët marrin pjesë në mbledhjet e njësisë bazë kur trajtohen çështje që kanë lidhje me ta. Në takimin me GVB përfaqësuesi i studentëve ishte pjesë aktive e diskutimeve. (Vizita në institucion, takim me NJSBC-në dhe GVB-në).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Të drejtat dhe detyrimet e aktorëve kryesorë si njësitë që ofrojnë programet e studimit, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë së programit janë të parashikuara në rregulloren e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Cilësisë dhe NJSBC-së. Kjo e fundit ka autonomi operative dhe akseson të gjitha të dhënat e institucionit, ndërsa Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë është organ kolegjial që garanton ruajtjen e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Ndër detyrat e NJSBC-së janë dhe vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore- shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit; gjurmimi i ecurisë së punësimit të studentëve; vlerësimi dhe publikimi i veprimtarive të përgatitura në njësi mbi vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, zhvillimin e cilësisë dhe miratimin e standardeve të cilësisë etj. (Evidenca nr. 19: Rregullorja për Funksionimin dhe

	Organizimin e NJSBC-së).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	KU “Bedër” garanton që në procedurat e sigurimit të cilësisë të përfshihen të gjithë aktorët e interesuar. Për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së këtij institucioni përfshihet si stafi akademik, ndihmës akademik, administrativ edhe studentët. Në analizat vjetore dhe seancat trajnuese për mbarëvajtjen e institucionit marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrative. GVJ-ja konstatoi nga vizita në institucion, se ka një ndërgjegjësim të të gjithë aktorëve të brendshëm: staf akademik, administrative, studentëve për rëndësinë e sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. Nga biseda me stafin akademik GVJ-ja evidentoi se anëtarët e personelit akademik janë njohur me draftin e raportit të GVB-së dhe kanë kontribuar në hartimin e tij. Stafi akademik, administrativ dhe studentët kanë njohuri të detyrave, të drejtave dhe objektivave si departament.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga RVB-ja rezulton se Senati Akademik ka për detyrë jo vetëm të ngrejë strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë por të sigurojë që të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces qofshin student apo staf akademik, administrativ të trajtohen me respekt dhe integritet pa përjetuar asnjë lloj pabarazie apo diskriminimi. Vlerësimi dhe siguri i cilësisë së programit është gjithëpërfshirës, duke bërë që të gjithë aktorët e brendshëm të jenë pjesë e këtij procesi. Njësitë kryesore, njësitë bazë dhe administrative i prezantojnë raportet vjetore të vetëvlerësimit në analiza vjetore të hapura për të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe administrative. GVJ-ja konstaton se një hap në sigurimin e barazisë është dhe miratimi nga KU “Bedër” i “Politka për barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet”. (Evidenca nr.103-Politka për barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet).
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e	Gjatë takimeve në institucion, GVJ-ja u informua se KU “Bedër” përfshin ekspertë të jashtëm në strukturat përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë sikurse janë Komisioni i Përhershëm dhe NJSBC-ja. Në këto takime GVJ-ja u informua se KU “Bedër” organizon takime dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve dhe palë të treta, të cilët i informojnë në lidhje me dinamikat e tregut të punës. Këta ekspertë janë pjesë e vlerësimit të brendshëm të programit, të cilët japin mendime në lidhje me efikasitetin e kompetencave të fituara në program. Programi Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi

programit dhe përmirësimin e saj.	Angleze" bashkëpunon me 4 institucione ku studentët e këtij programi mund të kryejnë praktikën profesionale. <i>GVJ-ja rekomandon që njësia bazë duhet të vlerësojë dhe përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme kurrikulën e programit nisur nga nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i>			
Konkluzione	<i>Në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit KU "Bedër" përfshin si aktorët e brendshëm ashtu dhe aktorët e jashtëm. Personeli akademik dhe administrativ si dhe studentët janë të përfaqësuar në të gjitha proceset e sigurimit të cilësisë. Institucioni garanton një pjesëmarrje të barabartë për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces si dhe siguron që procedurat e sigurimit të cilësisë të jenë transparente. Të gjitha strukturat e institucionit bashkëveprojnë dhe sigurojnë një shërbim cilësor në nxitjen dhe rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen zyrtare të KU "Bedër", GVJ-ja konstaton aksesueshmërinë e menjëhershme të të gjithë informacionit që lidhet me organizimin e përgjithshëm institucional, fakultetet dhe programet që ato ofrojnë, pranimi i studentëve, kërkimi shkencor etj. Studentët dhe palët e treta njihen mbi aktivitetet e lidhura me vlerësimin e cilësisë në programin e studimit përmes emailit dhe publikimit online të tyre. <i>Me qëllim rritjen e transparencës me studentët dhe palët e treta, GVJ-ja rekomandon publikimin në faqen zyrtare të KU "Bedër" të kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit funksionon ky institucion, sikurse janë Rregullorja Themelore dhe Statuti, Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë dhe gjithë rregulloret, raportet e përvitshme vjetore, vendimet e Senatit, pyetësorët e vlerësimit të cilësisë dhe rezultatet e dala prej tyre etj, pra., çdo veprimtari të lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i>

	(Evidence-Faqja zyrtare e KU "Beder"- www.beder.edu.al; https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga faqja zyrtare e KU "Bedër" GVJ-ja konstaton se vlerësimi i cilësisë në programin e studimit është transparent dhe brenda kornizës së ruajtjes së konfidencialitetit. Rezultatet e vlerësimit të programit janë të publikuara online duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale për individët e përfshirë në këtë process. Në përputhje me ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe Kodin e Etikës dhe Konfidencialitetin e të Dhënave, KU "Bedër" ka bërë publike në faqen zyrtare të tij të gjitha rezultatet e dala nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i programit të studimit. (https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports)
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga dokumentacioni në DVV, konstatohet nga GVJ-ja se në nivel institucioni hartohen planveprime për të përmbushur rekomandimet e dala nga raportet e vlerësimeve të jashtme. Gjatë takimit në institucion, GVJ-ja konstaton se njësia, çdo vit angazhohet në realizimin e raportit vjetor ku përveç analizës së procesit mësimor dhe kërkimor, paraqitet dhe problematikat e vitit që ka përfunduar dhe objektivat që duhet të arrihen përmes analizës SWOT. (Evidenca nr. 100: Planveprimi për Plotësimin e Rekomandimeve të BA për programin; Evidenca nr. 35: Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2022-2023)
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ-ja konstaton nga bisedat e realizuara me drejtuesin e njësie kryesore dhe njësisë bazë se rezultatet e dala nga instrumentet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta që përdor institucioni për të monitoruar cilësinë e programit reflektohen në raportimet periodike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Raportet mbi monitorimin e cilësisë të programit të studimit shpërndahen dhe diskutohen me të gjithë personelin akademik ku diskutohen aktivitete dhe iniciativa të reja lidhur me sigurimin e cilësisë. Ndjekja e zbatimit të vendimeve të marra në favor të përmirësimit të cilësisë së programit bëhet nga zyrat përgjegjëse.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari	GVJ-ja konstaton nga takimet me stafin akademik dhe studentët se në mënyrë konstante NJSBC-ja organizon takime informuese me qëllim

periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e tyre aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm. Publikimi i rezultateve të dala nga vlerësimet e brendshme dhe të jashtme në faqen zyrtare web të KU “Bedër” rrisin transparencën për këtë proces të rëndësishëm dhe ndërgjegjësojnë studentët dhe personelin akademik për rëndësinë e sigurimit afatgjatë të cilësisë në programin e studimit. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze gjithashtu organizon veprimtari informuese me studentët e secilit cikël studimi dhe garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”. (Vizita në institucion, takim me drejtuesen e departamentit dhe stafin akademik, studentët dhe NJSBC-në)			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur strukturat e nevojshme për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimeve. Veprimtaritë e institucionit të realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë janë të bëra publike dhe transparente për të gjitha aktorët e interesuar. Informimi i barabartë dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i personalit akademik, administrativ dhe studentëve për këtë proces ka ndikuar pozitivisht në sigurimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i> <i>GVJ-ja rekomandon bërjen publike të kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit funksionon ky institucion. Publikimin periodik të raporteve vjetore, ku reflektohet ecuria e programeve që ofron ky institucion dhe siguri i cilësisë së brendshme të tyre. Një vend të rëndësishëm zënë në këtë proces rezultatat e dala nga vlerësimi që studentët i bëjnë programit përmes pyetësorëve për lëndën dhe pedagogun, të cilat duhet të reflektohen në raporte dhe planet e masave që ndërmerren në nivel institucional dhe nga njësia kryesore/njësia bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” ofruar nga “Kolegji Universitar Bedër”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Pjesa më e madhe e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit kanë kualifikimin e duhur dhe mbajnë gradën Profesor i Asociuar dhe Doktor. Gjithashtu, institucioni ka angazhuar në programin e studimit pedagogë të huaj me përvojë.
2. Sistemi i automatizuar BIS krijon mundësi të administrimit online të të dhënave të studenteve dhe stafit akademik. Nëpërmjet këtij sistemi studentët informohen lidhur me gjithë ecurinë e tyre në program nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të tij si dhe me një sërë aktiviteteve të tjera. Ky sistem mundëson përfshirjen anonime të studentit në vlerësimin e cilësisë së programit.
3. Institucioni e mbështet financiarisht personelin akademik të angazhuar në programin e studimit në realizimin e konferencave, seminareve, workshop-eve, trajnimeve të ndryshme, leksioneve të hapura si dhe aktivitete të tjera shkencore.
4. Infrastruktura në shërbim të programit të studimit është e përshtatshme dhe moderne, çka ndihmon në zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Auditorët ku zhvillohen leksionet janë të pajisura me mjete didaktike moderne sikurse janë kompjuterat, projektorët, smartboardet etj.
5. Në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve institucioni ka vendosur jo vetëm bibliotekën fizike, e cila është e përshtatshme dhe e pajisur me kompjutera, por edhe platformën dixhitale JSTOR, në të cilën falë abonimit institucional ata kanë akses të plotë në një fond prej 12 milion botimesh në 75 disiplina.

Pika të dobta

1. Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” duhet riorganizuar në mënyrë që tu mundësojë studentëve të këtij programi marrjen e kompetencave konkurruese me kërkesat e tregut të punës. Kjo kërkon angazhimin periodik të programit në studimin e formalizuar të tregut të punës si dhe rishikimin e planit mësimor për të patur një balancim mes lëndëve gjuhësore dhe letrare, në mënyrë që të ketë një përputhje mes kompetencave që merren në këtë program dhe sektorët ku studentët mendohet se mund të punësohen (**Standardi III.4, Kriteri 2**).
2. Praktika profesionale si pjesë përbërëse e planit mësimor të programit nuk është e qartë në lidhje me orët që studenti kalon në institucionin pritës. Po kështu duhet rishikuar formulari i vlerësimit nga pedagogu i praktikës në mënyrë që ai të reflektojë vlerësimin që studenti mer nga institucioni pritës si dhe informacionin në dosjen e praktikës që përgatit studenti (**Standardi I.3, Kriteri 3; Standardi II.1, Kriteri 3**).
3. Mekanizmat dhe instrumentat matës specifikë që institucioni ka ngritur për të monitoruar dhe garantuar cilësinë e brendshme të programit të studimit nuk janë përdorur

periodikisht si dhe nuk janë shoqëruar me raporte të viteve të fundit, ku reflektohen këto rezultate apo hartohet ndonjë plan veprim që bazohet mbi këto rezultate. Publikimi i tyre në faqen zyrtare të institucionit është detyrim transparence ndaj publikut (**Standardi VI.1, Kriteri 4; Standardi VI.3, Kriteri 4**).

4. Literatura e përdorur në një pjesë të konsiderueshme të lëndëve e pasqyruar në sillabuset përkatëse, nuk është bashkëkohore. Po kështu, numri i librave të përfshirë në sillabuset e lëndëve që gjendet në bibliotekë për këtë program studimi është i pamjaftueshëm (**Standardi II.4, Kriteri 2; Standardi IV.3, Kriteri 1**).
5. Pavarësisht se vërehet një rritje e angazhimit në projekte ndërkombëtare dhe marrëveshje të shkëmbimit akademik apo bashkëpunime me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në nivel institucional, numri i mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve të këtij programi është i vogël. Një numër i ulët vërehet edhe në projektet, ku janë përfshirë anëtarë të personelit akademik në këtë departament (**Standardi VI.1, Kriteri 1; Standardi I.3, Kriteri 2**).

Rekomandime

1. GVJ-ja rekomandon që të rivlerësohet kurrikula e programit të studimit në mënyrë që të përshtatet plotësisht me emërtimin e tij dhe të ofrojë kompetencat e duhura për sektorët ku synon punësimin e studentëve.
2. GVJ-ja rekomandon që institucioni të kryejë dhe të raportojë përmes strukturave përgjegjëse sigurimin e cilësisë në programin e studimit. Shoqërimin e rezultateve të vlerësimit me hapa konkrete masash dhe bërjen e tyre publike si detyrim ndaj transparencës me studentët dhe publikun.
3. GVJ-ja rekomandon që departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze duhet të rritë pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare si dhe të punojë më tepër në drejtim të përfshirjes në marrëveshjet e shkëmbimit akademik dhe bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "English Language and Literature" provided by the Higher Education Institution KU "Beder"

Strengths and affirmations


1. The majority of the full-time academic staff in the study program have the appropriate qualification (Associate Professor and Ph.D). Also, the institution has engaged qualified foreign experts in the program.
2. The automated system BIS creates opportunities for the online administration of student and academic staff data. Through this system, students are informed about their entire progress in the program from the moment of registration to its completion, as well as a series of other activities. This system enables the anonymous involvement of the students in the evaluation of the internal quality of the program.



3. The institution gives the academic staff financial support for the realization of conferences, seminars, workshops, various trainings, open lectures and other scientific activities.
4. The infrastructure serving the study program is suitable and modern, which helps in the realization of an effective learning process. Auditoriums where lectures are held are equipped with modern didactic tools such as computers, projectors, smartboards, etc.
5. The academic staff and students have at their disposal for the realisation of the learning process and the academic research not only the physical library, which is convenient and equipped with computers, but also the JSTOR digital platform, in which thanks to the institutional subscription they have full access to a fund of 12 million publications in 75 disciplines.

Weaknesses

1. The curriculum of the study program Master of Sciences in "English Language and Literature" should be reorganized in order to provide students with competitive competencies according to the demands of the labor market. This requires a periodic engagement of the program in conducting formalized study of the labor market as well as reorganizing the curriculum to the point it achieves a balance between linguistic and literary knowledge. This will ensure the obtainment of competences which are appropriate for the sectors where the students of this program can be employed (**Standard II.1, Criterion 1; Standard III.4, Critrion 2**).
2. The professional practice as an integral part of the curriculum of the study program is not clear in relation to the hours that the student spends in the host institution. Likewise, all the components that lead to the final evaluation of the student such as the internship evaluation form, the lecturer's evaluation form and student's reflection on the activities during the internship need to be revised so that they reflect the student's final evaluation (**Standard I.3, Critrion 3; Standard II.1, Criterion.3**).
3. The specific mechanisms and instruments that the institution has set up to monitor and guarantee the internal quality of the study program have not been used periodically and have not been accompanied by reports, where results from the questionnaires are displayed and action plans are designed accordingly. The publication of these reports on the institution's official website is an obligation of transparency towards students and the general public (**Standard VI.1, Criterion 4; Standard VI.1, Critrion 4**).
4. The obligatory and recommended literature, listed in most of the syllabi is not contemporary. Likewise, the number of books for this program that is available in the library is insufficient (**Standard II.4, Criterion 2; Standard IV.3, Critrion 1**).
5. Despite the fact that at the institutional level the number of international projects and academic exchange agreements or collaborations with counterpart institutions inside and outside the country is considerable, the number of mobilities of the academic staff and students in this program is low. A low number is also observed in projects where members




of the academic staff in this department are involved (**Standard I.3, Critrion 2; Standard VI.1, Critrion 1**).

Recommendation

1. The EEG recommends that the curriculum of the study program be reorganized in order to fully fits its designation and provide appropriate competencies suitable for the potential work opportunities realted to the study program's mission and objectives.
2. The EEG recommends that the institution carry out and report through the responsible structures the results from the internal quality evaluation of the study program Master of Sciences in "English Language and Literature". The evaluation results should be accompanied with concrete action plans and be made public on its website as an obligation toward the transparency with students and the public.
3. The EEG recommends that the Department of Education and English Language should increase the participation of the students and academic staff in mobility programs and projects with counterpart institutions inside and outside the country.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X